



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

RAPORT I KONSOLIDUAR PËR VEPRIMTARINË FINANCIARE DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2024

PRILL 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

1	HYRJA.....	3
2	KUADRI LIGJOR.....	3
3	ANALIZA E BUXHETIT E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE 2024.....	4
3.1	Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksa dhe tarifa për vitin 2024.....	6
3.2	Transferta e pakushtëzuar dhe transfera të pakushtëzuar sektoriale 2024.....	42
3.3	Të ardhurat e Institucioneve të Varësisë 2024.....	44
3.4	Sponsorizimet dhe të ardhura të tjera 2024.....	45
4	ANALIZA E DETAJUAR E SHPENZIMEVE PËR VITIN 2024.....	45
5	ANALIZA E SHPENZIMEVE BASHKIA.....	48
6	DETAJIMI I BUXHETIT TË BASHKISË SIPAS PROGRAMEVE.....	59
6.1	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi – AA122.....	59
6.2	Siguria Publike – AB122.....	61
6.3	Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik Vendor – AC122.....	63
6.4	Mbrojtja e Mjedisit – AD122.....	65
6.5	Shërbimet Publike Vendore – AE122.....	66
6.6	Arsimi bazë dhe parashkollor – AG122.....	68
6.7	Arsimi i mesëm i përgjithshëm – AH122.....	69
6.8	Përkujdesi social – AI122.....	70
6.9	Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës – AJ122 & AK122.....	71
7	ANALIZA E DETAJUAR E SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE PËR INSTITUCIONET E VARËSISË.....	81
7.1	Analiza e shpenzimeve Ndërmarrja e Shërbimeve Publike- AE122.....	81
7.2	Analiza e shpenzimeve Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes -AG122 & AH122....	87
7.3	Analiza e shpenzimeve Kultura, Sport dhe Argëtim AF122.....	94
7.3.1	Qendra e Artit dhe Kulturës -AF122.....	94
7.3.2	Analiza e shpenzimeve Klubi Shumësportësh - AF122.....	99
7.4	Analiza e shpenzimeve Shtëpia e Foshnjës - AI122.....	102
7.5	Analiza e shpenzimeve Qendra e Zhvillimit Rezidencial -AI122.....	103
7.6	Analiza e shpenzimeve Qendra Ditore e Zhvillimit - AI122.....	103
8	Transferta e kushtëzuar 2024.....	104

1 HYRJA

Bashkia Korçë ka përgatitur raportin e konsoliduar të zbatimit të buxhetit për vitin 2024. Ky raport ofron një pasqyrë të detajuar mbi mënyrën se si janë menaxhuar dhe realizuar të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024. Raporti i konsoliduar bazohet edhe në raportin e monitorimit të vitit 2024, pasqyrat financiare vjetore, duke ruajtur krahasueshmërinë me planet e buxhetit vjetor. Gjithashtu raporti i konsoliduar siguron një vlerësim të plotë të zbatimit të buxhetit. Qëllimi i këtij raporti është të sigurojë transparencë, llogaridhënie dhe vlerësim të performancës financiare. Treguesit fiskalë dhe financiarë të vitit 2024, vlerësojnë gjendjen financiare, si dhe qëndrueshmërinë e institucionit.

Për vitin 2024 Bashkia Korçë pati si qëllim të jetë më e madhe, e para në art, kulturë e sport, një lokalitet që vrapon pa u ndalur drejt së ardhmes.

Investimet dhe projektet në fusha të ndryshme, që u financuan nga ky buxhet krijuan shtimin e mundësive për çdo banor në qytet dhe fshat, me potencial për rritjen e mirëqënies për çdo familje korçare. Pati zhvillim të mëtejshëm dhe rritje të ekonomisë lokale në fushat si: turizmi dhe bujqësia. Korça ka qenë kryeqendër e turizmit gjithëvjetor, ka pasur shtim të numrit të vizitorëve vendas e të huaj.

Nëpërmjet aktiviteteve apo projekteve që Bashkia ka realizuar gjatë vitit 2024 dhe konkretisht në fushën e inovacionit ka rritur mundësitë dhe ka nxitur punësimin e të rinjve.

Mbështetja e bizneseve të reja dhe në rritje ka vazhduar edhe gjatë vitit 2024, nëpërmjet politikave incentivuese që Bashkia ka ndërmarrë.

Gjithashtu vëmendja dhe mbështetja për të moshuarit dhe shtresat në nevojë ka qenë një nga prioritetet e Bashkisë.

2 KUADRI LIGJOR

Raporti i konsoliduar i zbatimit të buxhetit të vitit 2024 është në zbatim të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 51 “Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Realizimi i buxhetit të vitit 2024 është bazuar në:

Ligjin nr.97/2023 datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin plotësues nr.1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, VKB nr. 167 datë 29.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë”, VKB nr. 17 datë 15.2.2024 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2024”, VKB nr.43 datë 28.03.2024 “Për miratimin e rritjes së planit të të ardhurave dhe përdorimin e grantit për realizimin e projektit “Përfshirje sociale për ndryshim” midis Bashkisë Korçë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), VKB nr.85 datë 14.06.2024 “Për miratimin e projektit të Rezidencës Artistike dhe miratimin e fondit të alokuar nga Këshilli i Qarkut Korçë”, VKB nr.95 datë 26.06.2024 “Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit dhe përdorimin e financimit nga Trans Adriatic Pipeline AG (TAP-AG për objektin “Ndërtim lere plasmasi “Sheshi i Rungajës”, “Deko”, “Sheqe” dhe “Pandelimoni” Ekonomia Kullosore Rungajë”, VKB nr.112 datë 14.08.2024 “Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit të vitit 2024 dhe përdorimin e transfertave të pakushtëzuara sektoriale për rritjen e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për funksionin e arsimit parashkollor dhe funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, VKB nr. 136 datë 11.10.2024 “Për miratimin e rritjes së planit të buxhetit të vitit 2024 dhe përdorimin e transfertës së pakushtëzuar për rritjen e pagave të punonjësve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë”, pas zbatimit të VKM nr. 503 datë 1.8.2024 dhe VKM


nr. 422 datë 26.6.2024, si dhe VKB nr. 150 datë 31.10.2024 “Për miratim limiti dhe përdorimi i fondit të financuar nga Këshilli i Qarkut Korçë”, në vlerën 150 mijë lekë për Qendrën Rezidenciale të Zhvillimit.

3 ANALIZA E BUXHETIT E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE 2024

Buxheti i vitit 2024 për Bashkinë Korçë ka qenë në vlerën 2,538,490 mijë lekë. Burimet e financimit të disponueshme për vitin 2024 kanë qenë 2,107,368 mijë lekë. Përdorimi i burimeve ka qenë 1,938,953 mijë lekë ose 76% në raport me planin vjetor dhe krahasuar me vitin 2023 ka një rritje prej 14%. Burimet e financimit të planifikuara për vitin 2024 së bashku me përdorimin e tyre, paraqiten si më poshtë:

000/lekë								
Nr.	Burimet e financimit	Burimet e disponueshme 2022	Burimet e financimit 2023	Burimet e disponueshme 2023	Përdorimi i burimeve 2023	Burimet e financimit 2024	Burimet e disponueshme 2024	Përdorimi i burimeve 2024
1	Të ardhurat e trashëguara	191,202	194,322	194,322	103,817	222,519	222,519	142,757
2	Transferta e pakushtëzuar	463,898	550,379	550,379	516,473	598,629	598,629	589,607
3	Transferta e pakushtëzuar per rritjen e pagave					53,614	53,614	53,614
4	Transferta e pakushtëzuar - detyrime të prapambetura			64,490			46,095	
5	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	341,392	363,352	363,352	342,325	401,095	401,095	382,775
6	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + Institucionet e varësisë + të ardhurat sekondare	751,456	1,192,786	740,040	728,153	1,246,212	768,580	765,287
7	Sponsorizime dhe të ardhura të tjera	8,940	5,870	5,870	5,259	5,850	6,265	3,713
8	Grand nga AZHBR	24,756						
9	Grand nga M.SH.M.S	19,999						
10	Financim TAP					9,371	9,371	
11	Grand nga UNDP		1,800	1,800	1752	1200	1200	1200
	Total	1,801,643	2,308,509	1,920,253	1,697,779	2,538,490	2,107,368	1,938,953

Tabela 1: Burimet e financimit dhe përdorimi i tyre 2024




Nga tabela e mësipërme shohim se peshën më të madhe nga të gjitha burimet e financimit të përdorura gjatë vitit 2024 kanë qenë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore + të ardhurat nga institucionet e varësisë + të ardhurat

sekondare, të cilat zënë 39%, transferta e pakushtëzuar zë 32% dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale zë 20%. Theksojmë se gjatë vitit 2024 Bashkia Korçë ka përfutuar të ardhura edhe nga burime të tjera si psh: financim nga TAP për realizimin e investimeve, grand nga UNDP për financimin e kampit veror dhe të ardhura të tjera dhe sponsorizime, të cilat jepen të detajuara përgjatë materialit.

Buxheti i vitit 2024 u realizua në vlerën 1,938,953 mijë lekë ose në masën 76% kundrejt planit vjetor dhe realizimi sipas shpenzimeve ekonomike paraqitet si më poshtë:

Nr.	Shpenzimet	Fakt 2023	Plan 2024	Fakt 2024	% e realizimit
1	Shpenzime personeli (600+601)	814,377	979,170	902,304	92%
2	Shpenzimet operative (602)	541,484	879,068	656,767	75%
3	Subvencione (603)	10,626	11,142	10,201	92%
4	Transferta tek organizata të ndryshme (604)	110,710	154,336	126,827	82%
5	Transferta tek individët (606)	17,239	22,984	15,982	70%
6	Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës (609)	0	20,000		0%
7	Shpenzime principali & interesi (651+166)	40,451	39,100	36,070	92%
8	Hartim projektesh dhe oponenta teknike (230)	779	10000	3087	31%
9	Shpenzime kapitale (231)	162,113	422,690	187,715	44%
	TOTAL	1,697,779	2,538,490	1,938,953	76%

Tabela 2: Plani i shpenzimeve dhe realizimi i tyre 2024



Grafiku 1 : % e realizimit të shpenzimeve 2024

Siç shihet edhe nga tabela gjatë vitit 2024 për realizimin e shpenzimeve Bashkia Korçë ka përdorur 1,938,953 mijë lekë ose 14% më shumë krahasuar me vitin 2023 dhe realizuar në masën 76% kundrejt burimeve të planifikuara të vitit 2024.

Shpenzimet e personelit kanë një realizim prej 92%, shpenzimet operative 75%, shpenzimet për subvencione 92%, transferata tek organizata të ndryshme 82%, transferata tek individët 70%, shpenzime principali & interesi 92%, hartim projektesh dhe oponenca teknike 31%, dhe shpenzimet për investime kanë një realizim prej 44%, kundrejt planit.

Nëse krahasojmë këto shpenzime me një vit më parë shohim se shpenzimet e personelit kanë një rritje prej 11%, Kjo rritje vjen për shkak të rritjes së nivelit të pagave nga zbatimi i VKM nr 503 datë 1.8.2024 “Për disa ndryshime në VKM nr. 328 datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e Njësive të Vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të NJVV”, si dhe VKM 422 datë 26.6.2024 “Për një ndryshim në VKM nr. 326 datë 31.5.2023, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës publike”, të ndryshuar. Shpenzimet operative kanë një rritje prej 21%, për shkak të rritjes së shërbimeve, aktiviteteve apo projekteve të ndryshme që Bashkia ka realizuar. Pagesa për subvencionin urban ka qenë pothuajse në të njëjtin nivel, transfertat tek organizatat kanë një rritje prej 14%. Shpenzimet për investime ku përfshihen edhe hartimet e projekteve dhe oponencat teknike kanë një rritje prej 14%. Të gjitha këto shpenzime jepen të detajuara përgjatë materialit.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksa dhe tarifa për vitin 2024

Për vitin 2024 objektivat kryesore kanë qenë:

- Rritja e pajtueshmërisë vullnetare
- Rritja e performancës së mbledhjes së të ardhurave duke ju përafuar parashikimeve aktuale
- Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit dhe përmirësimi i klimës së marëdhënieve administratë – taksapagues
- Masat kundër informalitetit, ulja e borxhit tatimor dhe fokusi në mirëadministrim
- Ulja e kostove administrative për taksapaguesit
- Zbatim efikas i legjislacionit tatimor në fuqi
- Zgjerimi i bazës të taksapaguesve

Në arritjen e objektivave janë mbajtur në konsideratë:

- Përmirësimi i administrimit të mbledhjes së të ardhurave me efekte në rritjen e tyre.
- Efektet e paketës fiskale për vitin 2024 por dhe paketave të viteve paraardhëse.
- Forcimi i mbledhjes së taksave dhe transparenca

- Trajtimi i barabartë i taksapaguesëve
- Bashkëbisedimi dhe përfshirja e grupeve të interesit
- Shërbim cilësor dhe asistencë ndaj taksapaguesit

Përparësi dhe përqëndrim i veçantë gjatë vitit 2024 iu dha zgjerimit të bazës taksapaguese, përpjekjeve për evidentim dhe saktësim të të dhënave të disponuara, por dhe atyre të përditësuara, rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët. Gjithashtu dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet sporteleve tona në qendër apo dhe çdo njësi administrative, agjentit tatimor SH.R.U.K.K.O., sportelet e Postës Shqiptare të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit si dhe shtrirja dhe përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës dhe marrëdhënieve midis Bashkisë, qytetarëve dhe biznesit.

Politikat incentivuese, shoqëruar me lehtësim fiskal dhe me përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit, kanë ndikuar pozitivisht edhe në objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve, në gjetjen sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave në harmoni me shërbimet që ofrohen, dhënia e mundësisë së arkëtimit me këste edhe pranë njësive administrative ku banojnë, shpërndarja e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore familjare e plotpjesëtuar proporcionalisht çdo muaj në faturën e furnizimit me ujë, etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të suksesshme jo vetëm për zbutjen e problemeve ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e performancës nga viti në vit.

Politikat incetivuese dhe përjashtuese ndër të cilat përmendim:

1. Lehtësimi me 20% të vlerës së totalit të tarifave vendore subjektet të cilët kanë mbi 20 persona të punësuar gjatë vitit ushtrimor.
2. Përgjysmimi i tarifave vendore për subjektet të cilët kanë mbi 50 persona të punësuar gjatë vitit ushtrimor.
3. Lehtësimi me 20% të vlerës së totalit të tarifave vendore subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre me në fushën e institucioneve arsimore private si dhe ato subjekte që do të ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e arsimit privat plotësues ose jo plotësues, organizimit të trajnimeve dhe kualifikimeve në fusha të ndryshme profesionale.
4. Përgjysmimi i tarifave vendore për të gjitha OJF-të, të cilat objekt kryesor të veprimtarisë së tyre kanë aktivitetin sportiv.
5. Përjashtimi nga pagesa e tarifave lokale subjektet të cilat kanë mbi 100 persona të punësuar gjatë vitit ushtrimor.
7. Përjashtimi nga pagesa e taksës së ndërtesës familjet që përbëhen vetëm nga pensionistë
8. Përjashtimi nga pagesa e tarifave lokale familjet që përbëhen nga një pensionist dhe familjet që kryefamiljari i të cilave përfiton ndihmë ekonomike
9. Përjashtimi nga pagesa e tarifave vendore të gjitha familjet jo efektive të cilat pas verifikimeve të përsëritura nga administrata e lagjeve për njësinë administrative Korçë dhe nga njësitë respektive për njësitë e tjera administrative nuk gjenden në banesë dhe nuk banojnë në adresën e deklaruar.

- 10.Përrjashtimi nga pagesa e tarifave të gjithë familjet kryefamiljari e të cilave përfiton statusin e verbërisë.
- 11.Përrjashtimi nga pagesa e tarifave të gjithë familjet kryefamiljari e të cilave përfiton statusin e para-tetra plegjisë.
- 12.Përrjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjitha subjektet të cilat do të zhvillojnë për herë të parë aktivitet dhe regjistrohen nga studentë të diplomuar në universitete brenda dhe jashtë vendit gjatë vitit 2022 dhe 2023.
- 13.Përrjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjithë subjektet që do të regjistrojnë dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e artizanatit.
- 14.Përrjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjithë investitorët e huaj që do të hapin dhe zhvillojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në Bashkinë e Korçës.
- 15.Përrjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjithë subjektet që do të regjistrojnë dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e ICT (teknologji e informacionit), aktivitetin e tyre në fushën e institucioneve arsimore private si dhe ato subjekte që do të ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e arsimit privat plotësues ose jo-plotësues, oganizimit të trajnimeve dhe kualifikimeve në fusha të ndryshme profesionale.
- 16.Përrjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjithë fermerët që janë regjistruar me NIPT
- 17.Përrjashtimi nga pagesa e tarifave për vitin 2024 të gjithë organizatat jofitimprurëse që do të regjistrojnë dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në Bashkinë e Korçës.

Objektivi kryesor për realizimin e të ardhurave buxhetore të planifikuara në vitin 2024 është realizuar në masën 61.2 % ose 468,188 (mijë) lekë më pak se planifikimi buxhetor.

Ndër arsytet që ndikuan në këtë mosrealizim vlen të theksojmë:

Mungesa e likuiditetit.

Përditësimi i vazhdueshëm i informacionit për kapacitetet sidomos në sipërfaqet e pasurive të paluajjtëshme.

Tendenca për të shtyrë në limitet kohore detyrimin për pagimin e taksave dhe tarifave vendore (efekt që ndikon në uljen e arkëtimeve për detyrimet korente por edhe në rritjen e borxhit për atë vit ushtrimor).

Evidentimi i saktë i familjeve efektive (levizjet brenda dhe jashtë vendit).

Rritja e numrit të përfituesve në kategoritë përjashtimore.

Përlllogaritja e detyrimeve edhe për periudhën pararadhëse, e cila vazhdoi të ndikojë në mosrealizim.

Pavarësisht këtij niveli të arkëtimit të të ardhurave kundrejt planit, referuar arkëtimeve mujore gjatë vitit 2024, është siguruar njëtrajtshmëri në nivelet e të ardhurave mujore duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë për gjithë periudhën e vitit buxhetor.

Vijimi i performancës së punës dhe i procesit bashkëpunues, garanton më tej sigurimin e të ardhurave të veta buxhetore vjetore për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

Më poshtë po paraqesim tabelën e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore sipas ndarjes dhe grafikët ilustrues plan-fakt si dhe peshën specifike sipas përqindjes që zë çdo ndarje sipas llojit të taksave dhe tarifave:

Nr	EMERTIMI	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv)	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan)
I	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat	739,206,098	1,207,394,471
1	Taksat vendore	281,790,677	626,962,893
a.	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme:	177,731,932	289,665,297
	Taksa mbi ndërtesën	131,333,113	207,129,048
	Taksë ndërtese per familje	62,109,652	109,932,192
	Taksë ndërtese per biznes	69,223,461	97,196,856
	Taksa mbi truallin	19,967,113	24,672,790
	Taksë ndërtese per familje	1,177,600	5,105,074
	Taksë ndërtese per biznes	18,789,513	19,567,716
	Taksa mbi token bujqësore	26,431,706	57,863,459
b.	Tatim fitimi i thjeshtuar për biznesin e vogël	1,552,255	2,500,000
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	78,544,275	280,000,000
d.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	6,726,891	36,797,596
c.	Taksa e fjetjes në hotel	8,900,552	8,000,000
e.	Taksa e tabelës	8,334,772	10,000,000
2	Të ardhura jotatimore	362,888,319	454,731,578
a.	Tarifat e shërbimeve publike:	269,477,906	344,505,554
	Tarifë pastrimi	166,159,371	202,767,653
	Tarifë pastrimi për familje	84,268,244	104,483,621
	Tarifë pastrimi për biznes	80,837,494	96,128,032
	Tarifë pastrimi për institucione/ojf	1,053,633	2,156,000
	Tarifë ndriçimi	47,785,556	57,581,627
	Tarifë ndriçimi për familje	22,212,275	27,987,846
	Tarifë ndriçimi për biznes	25,280,698	28,993,281
	Tarifë ndriçimi për institucione/ojf	292,583	600,500
	Tarifë gjelbërimi	30,878,675	38,216,328
	Tarifë gjelbërimi për familje	12,170,683	15,483,693
	Tarifë gjelbërimi për biznes	18,452,676	22,211,535
	Tarifë gjelbërimi për institucione/ojf	255,316	521,100
	Tarifë mirmbajtje varreza	13,834,616	17,032,868
	Tarifë vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes	10,819,688	28,907,078
b.	Tarifa administrative	5,493,902	5,300,000
c.	Të tjera jo tatimore	87,916,511	104,926,024
3	Taksa të ndara	94,527,101.5	125,700,000
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	7,634,433	25,000,000

b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	51,043,386	55,000,000
c.	Renta minerare	275,079	700,000
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	35,574,204	45,000,000

Në tabelën më lart, pika 2, nën ndarja: b) tarifa administrative më e detajuar përbëhet nga :

Tarifë regjistrimi për leje transporti

Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi

Tarifë për leje ndërtimi

Çertifikatë për mbrojtje nga zjarri

Miratim projekti

Tarifa administrative dhe rregullatore të NJ.Vendore

Tarifë vendore për konfirmim hartash

Tarifë vendore për çertifikatë përdorimi

Pika 2, nën ndarja : c) të tjera jo tatimore më e detajuar përbëhet nga :

Tarifë për servitutit e kalimit në pronat publike

Tarifë parkimi

Tarifë mur perimetral

Tarifë për zënie hapësire publike

Tarifë për depozitimin e mbetjeve inerte

Të ardhura nga qira trualli, objekti dhe tokë bujqësore

Të ardhura nga shërbimet e M.Z.SH

Të ardhura nga marrje pylli me qira, nga shitja e drurëve, nga prodhimet medicinale dhe nga shitja e dokumentave të ankandit.

Të ardhura nga gjobat

Të ardhura nga qiratë banesa sociale, nga qira banesa në pronësi të Bashkisë, Enti i banesave

Tarifë regjistrimi biznesi

Kamatë vonesa


Të ardhura nga Dividenti KRWM

Tarifë për leje të ndryshme D.K.T



Analiza e realizimit sipas kategorive

Pjesën më të madhe të të ardhurave e përbëjnë të ardhurat jo tatimore me 30.1 %, të ardhurat nga taksat vendore me 23.3 % dhe të ardhurat nga taksat e ndara me 7.8 % të totalit të realizuar përgjatë vitit 2024.



-Të detajuar sipas zërave specifike për çdo ndarje paraqesim tabelën më poshtë:

Nr.	E M Ë R T I M I	Në %
A	Taksat vendore	23.3%
	Taksa mbi ndërtesën	10.9%
	Taksa mbi truallin	1.7%
	Taksa mbi tokën bujqësore	2.2%
	Tatim fitimi i thjeshtuar për biznesin e vogël	0.1%
	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	6.5%
	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	0.6%
	Taksa e fjetjes në hotel	0.7%
	Taksa e tabelës	0.7%
B	Të ardhura jotatimore	30.1%
	Tarifë pastrimi	13.8%
	Tarifë ndriçimi	4.0%
	Tarifë gjelbërimi	2.6%
	Tarifë mirmbajtje varreza	1.1%
	Tarifë vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes	0.9%
	Tarifa administrative	0.5%
	Të tjera jo tatimore	7.3%
C	Taksa të ndara	7.8%
	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	0.6%
	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	4.2%
	Tatim mbi të ardhurat personale	2.9%
	Totali A+B+C	61.2%

Të ardhurat për këto zëra në nivel dhe përqindje janë realizuar:

Bazuar në kapacitetet e detajuara në planfikimin buxhetor, i cili u miratua me vendimin nr. 167 dt. 29.12.2023 gjithashtu dhe në ndryshimet e pësuara gjatë vitit 2024, (periudha janar - 31 dhjetor) ku sipas të dhënave të

shkëmbyera me QKB, atyre të ngarkuara në sistem nga veprimet e kryera nga DRT-Korçë për tatimpaguesit që regjistrohen nga ana e tyre dhe familjeve të regjistruara rishtazi në Z. GJ. C. V - Bashkia Korçë rezulton se: Numri i subjekteve të regjistruara periudha janar - 31 dhjetor, sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e sistemit kompjuterik, rezulton: 345 tatimpagues gjithsej.

Numri i subjekteve që kanë aplikuar për ç' regjistrim periudha janar - 31 dhjetor, sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e sistemit kompjuterik, rezulton: 207 subjekte gjithsej.

Numri i subjekteve të cilat kanë kaluar me status pasiv periudha janar - 31 dhjetor, sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e sistemit kompjuterik, rezulton: 63 tatimpagues gjithsej.

Numri i familjeve të regjistruara, të cilat kanë krijuar një ekonomi familjare të shkëputur nga familja bazë, për periudhën janar - 31 dhjetor, sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e sistemit kompjuterik, rezulton: 248 familje gjithsej.

Numri i subjekteve të cilat kanë ndryshuar përgjegjësitë tatimore (kalim nga subjekte të biznesit të vogël në subjekte të biznesit të madh) periudha janar - 31 dhjetor, sipas të dhënave të nxjerra nga raportet e sistemit kompjuterik, rezulton: 16 tatimpagues gjithsej.

Realizimi i funksionit të regjistrimit të subjekteve dhe familjeve të reja është kryer nëpërmjet: Regjistrimeve në QKB, regjistrimeve të bizneseve të reja dhe mbikqyrjes së regjistrimit të tatimpaguesve të kategorisë OJF dhe ambulante që kryhet nga Drejtoria Rajonale Korçë si dhe regjistrimit të familjeve në Z.GJ.C.V- Bashkia Korçë .

Gjatë vitit 2024, (për periudhën janar- dhjetor) sipas të dhënave që disponojmë janë dërguar:

3,051 njoftim vlerësime tatimore për subjektet

3,305 njoftim vlerësime tatimore për familjarë të cilët nuk kanë një kontratë furnizimi me ujë të pijshëm

16 njoftime për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore (informacion i marrë nga DRT Korçë)

404 njoftim vlerësimi tatimor për subjektet e reja bazuar në informacionin e Q.K.B-së

743 njoftime të përsëritura

10,661 njoftime dhe kërkesa për pagesë (subjektet dhe familjarët të cilët nuk kaluan për ndjekje të mbledhjes me forcë të detyrimeve)

2,201 njoftim vlerësime tatimore për pasuritë e paluajhtëshme

9,326 njoftime për pronat familjare

1,835 urdhëra për vendosjen e bllokimit të llogarive bankare

10 urdhëra për vendosjen e barrës hipotekore


42 urdhëra për ekzekutim bankar për llogaritë e bllokuara të subjekteve dhe familjeve debitore

14 marrëveshje bashkëpunimi lidhur për pagesë me këste të detyrimeve tatimore për subjekte biznesi

70 marrëveshje bashkëpunimi lidhur për pagesë me këste të detyrimeve tatimore për familjarë
 Taksat dhe tarifat që ndikojnë më shumë dhe mbajnë peshë kryesore në realizimin e të ardhurave janë:
 tarifa e pastrimit e cila ka peshën kryesore me 13.8 % të të ardhurave të realizuara
 taksa mbi pasuritë e paluajtëshme (ndërtesë, truall, tokë bujqësore) e cila zë rreth 14.8 % të të ardhurave të realizuara
 tarifat e ndriçimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe mirëmbajtjes së sistemit ujitës të cilat zënë 8.6 % të të ardhurave të realizuara
 taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe legalizimet të cilat zënë 7.1 % të të ardhurave të realizuara
 taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve e cila zë 4.2 % të të ardhurave të realizuara
 tatimi mbi të ardhurat personale e cila zë 2.9 % të të ardhurave të realizuara
 Realizimi i të ardhurave për vitin 2024 krahasuar me vitet e kaluara

Në lekë

Vitet	Realizim 2021	Realizim 2022	Realizim 2023	Realizim 2024
Të ardhurat për periudhën	729,159,774	734,136,911	719,297,125	739,206,098



Të ardhurat nga burimet e veta vendore për vitin 2024 arritën vlerën 739,206,098 lekë. Duke marrë për bazë krahasimi 3 vite të periudhës paraardhëse na rezulton se:

Krahasuar me vitin 2021 rezulton me një diferencë prej 10,046,324 lekë më shumë.

Krahasuar me vitin 2022 rezulton me një diferencë prej 5,069,187 lekë më shumë.

Krahasuar me vitin 2023 rezulton me një diferencë prej 19,908,973 lekë më shumë.

Tabela më poshtë paraqet planifikimin dhe realizimin e taksave dhe tarifave për vitin 2024 si dhe realizimin për periudhën paraardhëse 2021-2023.

Nr	EMËRTIMI	Realizim 2021	Realizim 2022	Realizim 2023	Realizim 2024	Planifikim 2024	Në %
A	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	307,550,109	293,346,695	294,739,271	281,790,677	626,962,893	47%
1	TAKSË MBI NDËRTESËN	114,846,019	122,707,067	117,967,686	131,333,113	207,129,048	63%
2	TAKSË MBI TRUALLIN	12,601,210	12,042,427	12,725,319	19,967,113	24,672,790	81%
3	TATIM MBI TOKËN BUJQËSORE	20,386,785	20,387,837	22,155,006	26,431,706	57,863,459	46%
4	TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL	6,174,696	1,541,883	1,256,271	1,552,255	2,500,000	62%
5	TAKSË NDIK.INFRAST. NGA NDËRTIMET E REJA	134,234,446	104,224,382	114,985,138	78,544,275	280,000,000	28%
6	TAKSË NDIK.INFRAST.NGA LEGALIZIMET	5,429,441	16,782,885	10,743,943	6,726,891	36,797,596	18%
7	TAKSË HOTELI	5,956,660	7,737,460	7,376,395	8,900,552	8,000,000	111%
8	TAKSË TABELE	7,920,852	7,922,754	7,529,513	8,334,772	10,000,000	83%
B	TË ARDHURA JO TATIMORE	332,345,109	348,047,180	339,768,736	362,888,319	454,731,578	80%
1	TARIFË PASTRIMI	160,894,253	160,014,535	155,899,754	166,159,371	202,767,653	82%
2	TARIFË NDRIÇIMI	35,364,905	35,004,372	35,904,083	47,785,556	57,581,627	83%
3	TARIFË GJELBËRIMI	23,731,605	23,210,914	22,503,573	30,878,675	38,216,328	81%
4	TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA	12,809,101	13,149,366	12,436,440	13,834,616	17,032,868	81%
5	TARIFË PËR ZENIE HAPESIRE PUBLIKE	20,993,471	21,243,712	21,073,198	21,722,880	27,699,000	78%
6	TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJE TRANSPORTI	1,105,340	976,365	1,094,405	1,476,350	1,300,000	114%
7	TARIFË MUR PERIMETRAL	1,458,255	726,138	930,840	758,895	2,000,000	38%
8	TARIFË PARKIMI	20,566,853	19,396,160	18,738,137	19,522,111	22,000,000	89%
9	TË ARDHURA TË TJERA (vertetime,çertifikata etj.)	10,233,162	12,234,144	13,334,261	10,026,234	6,755,040	148%
10	ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI	523,250	325,000	468,000	436,000	425,000	103%
11	MIRATIM PROJEKTI	595,000	850,000	1,167,000	965,000	1,500,000	64%
12	SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIG.	0	0	0	11,250	50,000	23%
13	SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TE TRETJEVE	0	0	0	83,000	30,000	277%
14	MARRJE ME QERA PYLLI (KULLOTA+TOKE BUJQESORE)	3,816,355	8,712,064	7,323,335	5,660,751	8,031,200	70%
15	TË ARDH.NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT	1,600,000	2,346,060	0	0	100,000	0%
16	VËRTETIME TRANSPORTI	66,000	48,000	29,400	30,000	70,000	43%

17	PRODHIME TË DYTA MEDICINALE	0	0	0	0	1,000,000	0%
18	GJOBA POLICIA BASHKIAKE	688,000	311,000	181,000	346,000	1,400,000	25%
19	GJOBË PËR VONESË NË PAGESË	6,857,732	5,258,446	5,789,162	7,116,472	6,000,000	119%
20	GJOBA TË DREJT. SË KONTROLLIT TË TERRITORIT	75,000	15,000	70,000	40,000	200,000	20%
21	GJOBA INSPEKTORIATI I NDËRTIMIT	2,041,716	2,581,858	2,813,804	1,572,862	2,500,000	63%
22	GJOBA TË DREJTORISË SË TË ARDHURAVE	120,000	20,000	120,000	180,000	200,000	90%
23	QERA OBJEKTI + QERA TRUALLI + QERA TOKA BUJQESORE	8,860,957	8,549,473	10,426,524	9,612,474	9,017,585	107%
24	TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIMI	555,000	520,000	640,000	450,000	1,375,000	33%
25	TARIFË PËR LEJE NDËRTIMI	340,000	271,000	325,200	258,000	700,000	37%
26	TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONË PUBLIKE	618,740	680,870	697,334	806,101	1,339,255	60%
27	TË ARDH. NGA QERATË, BANESA SOCIALE	6,917,333	6,773,422	6,879,735	8,133,349	7,050,000	115%
28	TË ARDHURA NGA BANESA SHTETËRORE	0	0	92,886	102,333	84,000	122%
29	QERA NGA BANESAT NË PRON. TË BASHKISË, ENTI BANESAVE	1,352,353	13,464,724	168,464	96,000	149,144	64%
30	KAMAT VONESA (QIRA OBJEKTI)	230,043	492,276	295,019	232,542	300,000	78%
31	PRIVATIZIM BANESE	0	0	8,099,635	2,679,024	2,200,800	122%
32	TARIFË PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE	0	1,871,100	3,018,608	1,092,786	6,750,000	16%
33	TARIFË VJETORE E MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT TË UJITJES	9,930,685	9,001,182	9,248,941	10,819,688	28,907,078	37%
	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	89,264,556	92,743,036	84,789,118	94,527,102	125,700,000	75%
1	TATIM SHITJE PASURI E PALUAJTSHME	22,932,304	20,402,161	6,197,114	7,634,433	25,000,000	29%
2	TAKSË REGJISTRIMI E PËRVITSHME (AUTOMJETE)	43,262,884	44,057,543	46,259,021	51,043,386	55,000,000	93%
3	RENTA MINERARE	331,454	549,188	492,865	275,079	700,000	39%
4	DIVIDENTI NGA U.K. KO	647,175	2,801,366	0	0	0	0%
5	TË ARDHURA NGA TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE	22,090,739	24,932,778	31,840,118	35,574,204	45,000,000	79%
	TOTALI	729,159,774	734,136,911	719,297,125	739,206,098	1,207,394,471	61.2%

TË ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE

Të ardhurat nga taksat vendore janë planifikuar në vlerën 626,962,893 lekë dhe janë realizuar në vlerën 281,790,677 lekë ose 45 % e planifikimit. Ato kanë kontribuar me 38.12% të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024. Planifikimi në këtë masë ka ardhur si pasojë e planifikimit real të sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme, debitorëve për vitet paraardhëse sipas kufirit ligjor, ecurisë së arkëtimeve referuar periudhave paraardhëse dhe planifikimit nga drejtoritë e bashkisë. Duke iu referuar treguesve të detajuar të të ardhurave nga taksat vendore ka një rënie në raport me një vit më parë prej 12,948,594 lekë më pak.

Të detajuara paraqiten si më poshtë:

TAKSË MBI NDËRTESEN

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
1	Taksë mbi ndërtesën	207,129,048	131,333,113	63 %

Taksa mbi ndërtesën planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është taksa që ka kontribuar me 10.9 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit me 11 % më shumë ose 13,365,427 lekë. Niveli i arkëtimit ka pësuar rritje këtë vit me 5,708,906 lekë më shumë nga ndërtesat për qëllime banimi dhe 7,656,521 lekë më shumë nga ndërtesat për qëllime biznesi.

Për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 207,129,048 lekë dhe është realizuar në masën 63% kundrejt planifikimit ose në vlerë 131,333,113 lekë konkretisht nga:

370 subjekte të biznesit të madh në vlerën 23,233,970 lekë, detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 54 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2024 në vlerën 3,681,073 lekë.

929 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 10,204,440 lekë, detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 84 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2024 në vlerën 1,636,352 lekë.

4 organizata jo fitimprurëse në vlerën 29,258 lekë dhe 2 organizata debitore për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2024 në vlerën 106,577 lekë.

947 pronarë ndërtesash të cilët ambjentet e tyre ua kanë lëshuar me qira subjekteve të biznesit të madh apo të vogël në vlerën 14,495,939 lekë si dhe nga 385 pronarë ndërtesash debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2024 në vlerën 15,835,852 lekë.

abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2024 në vlerën 31,158,800 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2024 në vlerën 10,467,874 lekë.


abonentët familjarë të Njësive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2024 në vlerën 6,598,488 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitet 2017-2023 por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2024 në vlerën 2,844,807 lekë.

familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh pas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likuiduar detyrimet e vitit 2024 por edhe detyrimet e viteve të mëparëshme në vlerën 4,551,759 lekë.

familjarët rezidentë efektivë në Njësiti Administrative të Bashkisë Korçë që kanë likuiduar detyrimet e vitit 2024 në vlerën 1,500,317 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësiti Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e ndërtesës gjatë vitit 2024 në vlerën 4,987,607 lekë.

Detyrimi i taksës mbi ndërtesën për biznesin likuidohet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe likuidohet çdo muaj së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë në UKKO, në cilësinë e agjentit tatimor.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizimin total të taksës së ndërtesës po i ilustron grafikisht:



TAKSË MBI TRUALLIN

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
2	Taksë mbi truallin	24,672,790	19,967,113	81 %

Taksa mbi truallin planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është taksa që ka kontribuar më 1.7 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit me 57% më shumë ose 7,241,794 lekë. Niveli i arkëtimit ka pësuar rënie këtë vit me 606,644 lekë më pak nga truall për qëllim banimi nga individë dhe ka pësuar rritje me 7,848,438 lekë më shumë truall për qëllime biznesi.


Taksa mbi truallin për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 24,672,790 lekë dhe është realizuar në masën 81 % kundrejt planifikimit ose në vlerë 19,967,113 lekë. Taksa mbi truallin përfshin kategoritë e truallit për biznes dhe truallit për banim. Kjo taksë është arkëtuar në këtë nivel:

Nga 162 subjekte të biznesit të madh në vlerën 10,909,110 lekë, detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 18 subjekte të biznesit të madh debitorë por që kryen pagesën për taksën e truallit gjatë vitit 2024 në vlerën 1,557,858 lekë.

Nga 90 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 1,020,825 lekë, detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 19 subjekte të biznesit të vogël debitorë por që kryen pagesën për taksën e truallit gjatë vitit 2024 në vlerën 319,966 lekë. Nga poseduesit e truallit për biznes dhe për banim në territorin e Bashkisë Korçë në vlerën 4,981,754 lekë. Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë likujduar detyrimet e vitit 2024 në vlerën 231,575 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për taksën e truallit gjatë vitit 2024 në vlerën 946,025 lekë.

Detyrimi i taksës mbi truallin për biznesin likujdohet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe likujdohet çdo muaj së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë në UKKO, në cilësinë e agjentit tatimor.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizimin total të taksës mbi truallin po i ilustronjmë grafikisht:



TAKSË MBI TOKËN BUJQËSORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
3	Taksë mbi tokën bujqësore	57,863,459	26,431,706	46%

Taksa mbi tokën bujqësore planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Është taksa që ka kontribuar me 2.2 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024. Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2024 është planifikuar 57,863,459 lekë dhe është realizuar në masën 46 % kundrejt planifikimit ose në vlerën 26,431,706.21 lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit me 19 % më shumë ose 4,276,700 lekë. Kjo shumë është arkëtuar nga poseduesit e tokës bujqësore në Bashkinë Korçë që kryen pagesën për detyrimin e vitit 2024 në vlerën 10,709,838 lekë dhe nga debitorët e viteve paraardhëse të cilët kryen pagesën gjatë vitit 2024 në vlerën 15,721,868 lekë.

Vlera prej 15,721,868 lekë detyrime këto prej viteve të mëparshme është mundur të arkëtohet si rezultat i punës në terren, dërgimit të 1,973 njoftime për pagesë për poseduesit e tokës bujqësore në Njësinë Administrative

Bulgarec; 2,132 njoftime për pagesë për poseduesit e tokës bujqësore në Njësinë Administrative Drenovë; 850 njoftime për pagesë për poseduesit e tokës bujqësore në Njësinë Administrative Mollaj; 634 njoftime për pagesë për poseduesit e tokës bujqësore në Njësinë Administrative Voskop, 168 njoftime për pagesë për poseduesit e tokës bujqësore në Njësinë Administrative Voskopojë; 775 njoftime për pagesë për poseduesit e tokës bujqësore në Njësinë Administrative Vithkuq; 604 njoftime për pagesë për poseduesit e tokës bujqësore në Njësinë Administrative Lekas, 485 njoftime për pagesë për poseduesit e tokës bujqësore në Njësinë Administrative Korçë).

Kjo taksë ka një mosrealizim prej 31,431,753 lekë kundrejt planifikimit të vitit 2024.

Pavarësisht se viti 2024 pati një rritje të arkëtimeve debitore krahasuar me vitin paraardhës vazhdon të mbetet problematikë që taksa mbi tokën bujqësore është taksa që kundërshtohet më shumë nga ana e taksapaguesve pasi shumica e tyre kundërshtojnë faturat të cilat kanë të përfshira dhe detyrimet debitore të trashëguara.

Realizimi prej 26,431,706 lekë është arkëtuar i detajuar si më poshtë:

Njësia Administrative Bulgarec ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 1,589,060 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 5,384,576 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Njësia Administrative Drenovë ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 1,024,226 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 2,230,497 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Njësia Administrative Mollaj ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 758,614 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 1,642,301 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Njësia Administrative Voskop ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 1,371,144 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 1,940,442 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Njësia Administrative Voskopojë ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 300,852 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 1,017,381 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Njësia Administrative Vithkuq ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 399,382 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 1,758,728 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Njësia Administrative Lekas ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 50,631 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 103,685 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Njësia Administrative Korçë ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 924,796 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 1,644,258 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Nga abonentët familjarë të Njërive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2024 në vlerën 4,291,133 lekë

TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
4	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	2,500,000	1,552,255	62 %

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël administrohet, pas miratimit të ndryshimeve ligjore sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, datë 30/08/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, arkëtohet nga bizneset e vogla, dhe më pas i transferohet Bashkisë nga Drejtoria Rajonale Tatimore, në rolin e agjentit tatimor.

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël në buxhetin e vitit 2024 është planifikuar në vlerën 2,500,000 lekë dhe është realizuar në masën 62 % kundrejt planifikimit ose në vlerë 1,552,255 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i zbatimit të masave shtrënguese sipas legjislacionit në fuqi për arkëtimin e detyrimeve paraardhëse si taksë vendore të pa paguara nga 17 subjekte debitore në vlerën 563,175 lekë dhe nga arkëtimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në vlerën 989,080 lekë konkretisht nga:

7 subjekte për vitin 2014 me vlerë	101,058 lekë
15 subjekte për vitin 2015 me vlerë	272,607 lekë
4 subjekte për vitin 2016 me vlerë	20,000 lekë
3 subjekte për vitin 2017 me vlerë	50,003 lekë
5 subjekte për vitin 2018 me vlerë	37,558 lekë
13 subjekte për vitin 2019 me vlerë	57,254 lekë
11 subjekte për vitin 2020 me vlerë	77,975 lekë
11 subjekte për vitin 2021 me vlerë	55,000 lekë
19 subjekte për vitin 2022 me vlerë	86,668 lekë
35 subjekte për vitin 2023 me vlerë	230,957 lekë

Të gjitha vlerat mësipër janë mbledhur dhe janë derdhur për llogari të Bashkisë Korçë nga DRT Korçë si tatim i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël ku kjo e fundit bazuar në legjislacionin aktual në fuqi është në rolin e agentit tatimor.

TAKSË E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
5	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	280,000,000	78,544,275	28%

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Është taksa që ka kontribuar me 6.5 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 280,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 28 % kundrejt planifikimit ose në vlerën 78,544,275 lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rënie në nivelin e arkëtimit me 32 % më pak ose 36,440,863 lekë.

Kjo taksë është realizuar konkretisht nga:

Leje me destinacion banimi në vlerën	59,318,556 lekë.
Leje me destinacion banim + social-ekonomike në vlerën	11,628,158 lekë.
Leje me destinacion ekonomik në vlerën	7,597,561 lekë.

TAKSË E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	36,797,596	6,726,890	18 %

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 36,797,596 lekë dhe është realizuar në masën 18 % kundrejt planifikimit ose në vlerën 6,726,890 lekë.

Realizimi i kësaj takse vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:

98 taksapagues që kanë paguar detyrimin për vitin 2024 në vlerën 3,426,356 lekë

79 taksapagues që kanë paguar detyrimet e viteve të mëparëshme gjatë vitit 2024 në vlerën 3,300,535 lekë

TAKSË E FJETJES NË HOTEL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
7	Taksa e fjetjes në hotel	8,000,000	8,900,552	111 %

Taksa e fjetjes në hotel planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Taksë fjetje në hotel për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 8,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 111 % kundrejt planifikimit ose në vlerën 8,900,552 lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit me 21 % më shumë ose 1,524,157 lekë.

Nga kontrollet e ushtruara gjatë vitit 2024 janë mbajtur gjithsej 1,639 aktkonstatime ku janë verifikuar dhe kontrolluar regjistrat e fjetjes në lidhje me deklarin e personave të akomoduar në çdo subjekt që ushtron aktivitet “Hoteleri/Bujtinë” ose ofron shërbimin e fjetjes kundrejt pagesës në territorin e Bashkisë Korçë.

Kjo taksë është arkëtuar në vlerën prej 8,900,552 lekë nga:

133 subjekte që kanë deklaruar një numër akomoduesish prej 104,392 persona/shtretër në vlerën 7,307,454 lekë detyrime këto të vitit 2024 (pa përfshirë detyrimin e muajit dhjetor 2024 i cili deklarohet dhe paguhet në janar të vitit 2025 sipas afatit të miratuar në paketën fiskale). Në krahasim me vitin paraardhës ka ndryshuar si nr i subjekteve i cili ka pësuar rritje me 10 subjekte ashtu edhe nr i akomodimeve i cili ka pësuar rritje me 13,698 persona të deklaruar.

120 subjekte që kanë deklaruar një numër akomoduesish prej 16,895 persona/shtretër në vlerën 1,182,650 lekë, detyrim ky i muajit dhjetor 2023 i cili deklarohet dhe paguhet në janar të vitit 2024 sipas afatit të miratuar në paketën fiskale.

Nga 32 subjekte debitorë të viteve të mëparëshme që e kryen pagesën gjatë vitit 2024 në vlerën 410,448 lekë.

TAKSË TABELLE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
8	Taksë table	10,000,000	8,334,772	83%

Taksa e tabelës planifikohet nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është taksa që ka kontribuar me 0.7 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024.


Taksa e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 10,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 83 % kundrejt planifikimit ose në vlerë 8,334,772 lekë. Kjo taksë është realizuar nga:

Nga 80 subjekte të cilat kanë vendosur tabelë për qëllime identifikimi dhe reklamimi në vlerën 7,978,417 lekë, detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 25 subjekte debitorë por që kryen pagesën për taksën e tabelës për qëllime identifikimi dhe reklamimi gjatë vitit 2024 në vlerën 356,355 lekë.

Më poshtë po paraqesim tabelën dhe grafikun me peshën specifike që zë secila taksë vendore kundrejt totalit të realizimit për pjesën e taksave vendore për vitin 2024.

Nr	Emërtimi	Në %
A	Taksat vendore	
1	Taksa mbi ndërtesën	46.6 %
2	Taksa mbi truallin	4.1 %
3	Taksa mbi tokën bujqësore	9.4 %
4	Tatim fitimi i thjeshtuar për biznesin e vogël	0.6 %
5	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	27.9 %
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	2.4 %
7	Taksa e fjetjes në hotel	3.2 %
8	Taksa e tabelës	3 %

Taksat vendore



TË ARDHURA JO TATIMORE

Të ardhurat jo tatimore janë planifikuar në nivelin 454,731,578 lekë dhe janë realizuar në nivelin 362,888,319 lekë ose 80 % e planifikimit. Ato kanë kontribuar me 49.09% të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024. Planifikimi në këtë masë ka ardhur si pasojë e planifikimit real të kapaciteteve, zgjerimit të bazës, ndjekjes së debitorëve për vitet paraardhëse sipas kufirit ligjor, ecurisë së arkëtimeve referuar periudhave paraardhëse dhe planifikimit nga drejtoritë e Bashkisë. Duke ju referuar treguesve të detajuar të të ardhurave jo tatimore, rritja në raport me një vit më parë është 7 % ose e shprehur në shifra 23,119,583 lekë.

Të detajuara paraqiten si më poshtë:

TARIFË E PASTRIMIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
1	Tarifë e Pastrimit	202,767,653	166,159,371	82 %

Tarifa e pastrimit planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është tarifa që ka kontribuar më shumë dhe ka mbajtur peshën kryesore në realizimin e të ardhurave me 13.8 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024.

Tarifa e pastrimit për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 202,767,653 lekë dhe është realizuar në masën 82 % kundrejt planifikimit ose në vlerë 166,159,371 lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit me 7 % më shumë ose 10,259,617 lekë. Niveli i arkëtimit ka pasur rritje këtë vit me 7,547,257 lekë më shumë nga tarifa e pastrimit për çdo familje dhe 2,712,360 lekë më shumë tarifa e pastrimit nga subjektet tregëtare.

Kjo shumë është arkëtuar:

Nga 698 subjekte të biznesit të madh në vlerën 44,464,901 lekë, detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 71 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2024 në vlerën 3,266,503 lekë.

Nga 2429 subjekte të Biznesit të Vogël në vlerën 24,871,984 lekë, detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 247 subjekte të Biznesit të Vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2024 në vlerën 2,281,598 lekë.

Nga 78 subjekte ndërtuese që kanë paguar tarifën e pastrimit për çdo kantier ndërtimi pasi kanë tërhequr lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Korçë, në vlerë 5,105,008 lekë detyrime këto të vitit 2024.

Nga 66 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 1,762,500 lekë detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 8 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2024 në vlerën 138,633 lekë.

Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2024 në vlerën 52,294,829 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2024 në vlerën 17,754,107 lekë.


Nga abonentët familjarë të Njësive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2024 në vlerën 5,866,516 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2024 në vlerën 2,531,256 lekë.

Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2024 në vlerën 608,423 lekë, nga abonentët familjarë rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2024 në vlerën 2,146,176 lekë.

Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë likujduar detyrimet e vitit 2024 në vlerën 920,000 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e pastrimit gjatë vitit 2024 në vlerën 2,146,937 lekë.

Detyrimi i tarifës së pastrimit për biznesin likujdohet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe likujdohet çdo muaj së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë në UKKO, në cilësinë e agjentit tatimor.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizimin total të tarifës së pastrimit po i ilustruam grafikisht:



TARIFË NDRIÇIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
2	Tarifë Ndriçimi	57,581,627	47,785,556	83%

Tarifa e ndriçimit planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është tarifa që ka kontribuar me 4 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024.

Tarifa e ndriçimit për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 57,581,627 lekë dhe është realizuar në masën 83% kundrejt planifikimit ose në vlerë 47,785,556 lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit me 33 % më shumë ose 11,881,473 lekë. Niveli i arkëtimit ka pësuar rritje këtë vit me 5,352,927 lekë më shumë nga tarifa e ndriçimit për çdo familje dhe 6,528,546 lekë më shumë tarifa e ndriçimit nga subjektet tregëtare. Kjo shumë është arkëtuar:

Nga 678 subjekte të biznesit të madh në vlerën 9,246,733 lekë, detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 48 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2023 në vlerën 476,316 lekë.

Nga 2421 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 14,050,095 lekë, detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 238 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2024 në vlerën 922,632 lekë.

Nga 78 njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi në vlerë 372,005 lekë detyrime këto të vitit 2024.

Nga 66 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 473,417 lekë detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 7 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2024 në vlerën 32,083 lekë.

Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2024 në vlerën 13,406,455 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2024 në vlerën 3,341,510 lekë.


Nga abonentët familjarë të Njësive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2024 në vlerën 2,695,774 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2024 në vlerën 837,206 lekë.

Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2024 në vlerën 165,373 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2024 në vlerën 480,282 lekë.

Nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë që kanë likujduar detyrimet e vitit 2024 në vlerën 427,117 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e ndriçimit gjatë vitit 2024 në vlerën 858,558 lekë.

Detyrimi i tarifës së ndriçimit për biznesin likujdohet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe likujdohet çdo muaj së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë në UKKO, në cilësinë e agjentit tatimor.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizimin total të tarifës së ndriçimit po i ilustruam grafikisht:



TARIFË GJELBËRIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
3	Tarifë Gjellbërimi	38,216,328	30,878,675	81%

Tarifa e gjellbërimit planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është tarifa që ka kontribuar me 2.6 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024.

Tarifa e gjellbërimit për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 38,216,328 lekë dhe është realizuar në masën 81 % kundrejt planifikimit ose në vlerë 30,878,675 lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit me 37 % më shumë ose 8,375,103 lekë. Niveli i arkëtimit ka pasur rritje këtë vit me 3,375,375 lekë më shumë nga tarifa e gjellbërimit për çdo familje dhe 4,999,728 lekë më shumë nga tarifa e gjellbërimit nga subjektet tregëtare.

Kjo shumë është arkëtuar:

Nga 675 subjekte të biznesit të madh në vlerën 5,905,778 lekë, detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 45 subjekte të biznesit të madh debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjellbërimit gjatë vitit 2024 në vlerën 324,933 lekë.

Nga 2201 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 10,862,892 lekë, detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 191 subjekte të biznesit të vogël debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjellbërimit gjatë vitit 2024 në vlerën 646,156 lekë.

Nga 78 njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi në vlerë 528,000 lekë detyrime këto të vitit 2024.


Nga 65 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse në vlerën 408,150 lekë detyrime këto të vitit 2024 si dhe nga 7 institucione shtetërore dhe organizata jo fitimprurëse debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2024 në vlerën 32,083 lekë.

Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2024 në vlerën 9,396,364 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2024 në vlerën 2,386,660 lekë.

Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likuajduar detyrimet e vitit 2024 në vlerën 105,229 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e gjelbërimit gjatë vitit 2024 në vlerën 282,430 lekë.

Detyrimi i tarifës së gjelbërimit për biznesin likuajdohet bashkë me detyrimet e tjera vjetore, ndërsa detyrimi për familjet llogaritet dhe likuajdohet çdo muaj së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë në UKKO, në cilësinë e agjentit tatimor.

Realizimet e mësipërme sipas % që këto arkëtime zenë në realizimin total të tarifës së gjelbërimit po i ilustruam grafikisht:



TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
4	Tarifë mirëmbajtje varreza publike	17,032,868	13,834,616	81 %

Tarifa për mirëmbajtjen e varrezave publike planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është tarifa që ka kontribuar me 1.1 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024.

Tarifa për mirëmbajtjen e varrezave publike për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 17,032,868 lekë dhe është realizuar në masën 81 % kundrejt planifikimit ose në vlerë 13,834,616 lekë. Krahasuar me vitin e kaluar, ka pësuar rritje në nivelin e arkëtimit për këtë tarifë me 11 % më shumë ose 1,397,176 lekë.

Kjo shumë është arkëtuar:

Nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2024 në vlerën 6,880,899 lekë si dhe nga abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me UKKO që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2024 në vlerën 2,529,761 lekë.

Nga abonentët familjarë të Njësive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kyer pagesat për vitin 2024 në vlerën 1,955,505 lekë si dhe nga abonentët familjarë të Njësive Administrative të cilët ishin debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën në vitin 2024 në vlerën 884,646 lekë.

Nga familjarët rezidentë efektivë pa kontratë me UKKO të cilët janë paraqitur pranë nesh mbas njoftimeve të kryera nga ana jonë dhe kanë likujduar detyrimet e vitit 2024 në vlerën 85,560 lekë, nga familjarët rezidentë efektivë të cilët nuk kanë kontratë me UKKO, që kanë qenë debitorë për vitet paraardhëse por që kryen pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2024 në vlerën 338,119 lekë.

Nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë në vlerën 296,032 lekë si dhe nga familjarët rezidentë efektivë në njësitë administrative të Bashkisë Korçë të cilët ishin debitorë për vitet paraardhëse dhe kanë kryer pagesën për tarifën e varrezës gjatë vitit 2024 në vlerën 864,094 lekë.

TARIFË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
5	Tarifë për zënien e hapësirave publike	27,699,000	21,722,880	78 %

Tarifë për zënie hapësire publike planifikohet nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.


Tarifë për zënie hapësire publike për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 27,699,000 lekë dhe është realizuar në masën 78 % ose në vlerë 21,722,880 lekë. Më të detajuar po e paraqesim më poshtë:

Tek inkubatori i biznesit (ish U.M.B) dhe Markata e Shijes detyrim i vitit 2024 në vlerën 5,629,198 lekë dhe për vitet paraardhëse në vlerën 397,800 lekë.

Hapësirë publike detyrim i vitit 2024 në vlerën 12,130,802 lekë dhe për vitet paraardhëse në vlerën 1,328,572 lekë.

Ekspozim malli detyrim i vitit 2024 në vlerën 1,268,508 lekë dhe për vitet paraardhëse në vlerën 105,150 lekë.

Tek tregu i gjësë së gjallë në vlerën 862,400 lekë.



TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
6	Tarifë regjistrimi për lejë transporti	1,300,000	1,476,350	114%

Tarifa e regjistrimit për lejë transporti planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit.

Tarifë regjistrimi leje transporti për vitin 2024 është planifikuar 1,300,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit është realizuar në masën 114 % ose në vlerë 1,476,350 lekë. Realizimi i kësaj tarife vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:

Transport malli (licensim & çertifikim) në vlerën 155,010 lekë.

Transport udhëtarësh me taksë në vlerën 571,340 lekë.

Transport udhëtarësh me linjë qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse në vlerën 126,750 lekë.

Autorizime kamioni të tonazhit të rëndë në vlerën 623,250 lekë.

TARIFË MUR PERIMETRAL

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
7	Tarifë mur perimetral	2,000,000	758,895	38%

Tarifë mur perimetral planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Tarifë mur perimetral për vitin 2024 është planifikuar 2,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 38 % ose në vlerë 758,895 lekë. Kjo tarifë është realizuar konkretisht nga:

Leje për destinacion banimi në vlerën 414,555 lekë.

Leje për destinacion banim+ekonomike në vlerën 115,200 lekë.

Leje për destinacion ekonomik në vlerën 229,140 lekë.

TARIFË PARKIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
8	Tarifë Parkimi	22,000,000	19,522,111	89%

Tarifë parkimi planifikohet nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe arkëtohet pjesërisht nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nga vetë strukturat e Drejtorisë Kontrollit të Territorit.

Tarifë parkimi për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 22,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 89 % ose në vlerë 19,522,111 lekë. Realizimi i kësaj tarife vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:

Tarifa e parkimit të rezervuar për institucionet shtetërore apo subjektet private që kanë kryer pagesën për vitin 2024 në vlerën 5,136,000 lekë duke përfshirë këtu dhe detyrimet debitorë për vitet paraardhëse në vlerën 337,061 lekë.

Tarifë parkimi nga subjektet transport malli në vlerën 260,800

Tarifë parkimi me pagesë për rezidentë në vlerën 39,600 lekë.

Tarifa e parkimit me pagesë (bileta) në vlerën 13,748,650 lekë.

TË ARDHURA TË TJERA, VËRTETIME, ÇERTIFIKATA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
9	Të ardhura të tjera, vërtetime, çertifikata etj.	6,755,040	10,026,234	148 %

Të ardhura të tjera ku përfshihen (tarifa shërbimi, vërtetime, çertifikata, lejë ushtrimi aktiviteti, tarifë regjistrim biznesi, etj), për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 6,755,040 lekë dhe është realizuar në masën 148 % ose në vlerën 10,026,234 lekë.

Këtë realizim po e detajojmë sipas zërave:

Tarifë regjistrim biznesi në vlerën 90,000 lekë (arkëtuar nga 8 subjekte debitor)

Kamatë vonesa në vlerën 241,054 lekë

Tarifë administrative dhe rregullatore e njësisve vendore në vlerën 75,580 lekë

Tarifë licence për shitje me pakicë të lëndëve djegëse apo leje për ushtrim aktiviteti në vlerën 6,000,000 lekë

Tarifë për dhënie në përdorim të tubacioneve nëntokësore në vlerën 18,280 lekë

Tarifë vendore për lëshime vërtetimi në vlerën 387,700 lekë

Tarifë vendore për konfirmime hartash në vlerën 4,900 lekë

Tarifë vendore për çertifikata përdorimi në vlerën 1,346,122 lekë

Të ardhura nga dividendi KRWM në vlerën 1,421,389 lekë

Të ardhura nga tenderat në vlerën 441,209 lekë

ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
10	Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	425,000	436,000	103%

Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 425,000 lekë dhe është realizuar në masën 103% ose në vlerën 436,000 lekë. Më të detajuara po i paraqesim më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Nr. i rasteve	Realizimi për vitin 2024
1	Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	85	425,000
2	Vërtetime të ndryshme	9	9,000
3	Rinovim çertifikate mbrojtje nga zjarri	1	2,000
	TOTALI		436,000

Ky realizim në këtë vlerë ka ardhur si rezultat i kërkesës për pajisje me CZS për objektet e reja si dhe objekteve ekzistuese, nga ndryshimi i destinacionit kryesisht nga banesa individuale në ndërtesa me shërbim hoteleri dhe bujtina.

MIRATIM PROJEKTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
11	Miratim projekti	1,500,000	965,000	64 %

Tarifa për miratim projekti planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Miratim projekti për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 1,500,000 lekë dhe është realizuar në masën 64 % ose në vlerën 965,000 lekë. Kjo tarifë është arkëtuar konkretisht nga miratimi i projekteve të mbrojtjes nga zjarri për çdo lejë ndërtimi dhe konkretisht janë miratuar 124 raste.

Ky realizim në këtë vlerë ka ardhur si rezultat i aplikimit të tarifës për ndërtimet e reja si dhe ato të mbartura nga vitet paraardhëse, nga ndryshimet e destinacionit të objekteve ekzistuese kryesisht në objekte banimi në shërbime hoteleri dhe bujtina si dhe mënyrës së aplikimit të tarifave bazuar në kategorinë e tyre, lartësisë dhe sipërfaqes për aktivitet.

SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
12	Shërbime zjarrfikse në objekte të siguruara	50,000	11,250	23%

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Shërbime zjarrfikse në objekte të siguruara për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 50,000 lekë dhe është realizuar në masën 23% ose në vlerën 11,250 lekë. Gjatë vitit 2024 pati gjithsej 2 raste për ndërhyrje në objekte të siguruara.

SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TË TRETËVE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
13	Shërbime zjarrfikse ndaj të tretëve	30,000	83,000	277%

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Shërbime zjarrfikse ndaj të tretëve për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 30,000 lekë dhe është realizuar në masën 277% ose në vlerën 83,000 lekë. Gjatë vitit 2024 pati gjithsej 17 raste për shërbime zjarrfikse ndaj të tretëve.

MARRJE ME QIRA PYJE/KULLOTA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
14	Marrje me qira pyje/kullota	8,031,200	5,660,751	70 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjores.

Marrje me qira pylli për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 8,031,200 lekë dhe është realizuar në masën 70 % ose në vlerën 5,660,751 lekë. Kjo vlerë është arkëtuar nga:

2 kontrata qiraje të lidhura me qëllim pushim, argëtim në vlerën 220,085 lekë,

4 kontrata qiraje të lidhura me kompanitë celulare në vlerën 803,803 lekë,

5 kontrata qiraje të lidhura për ndërtim HEC-i në vlerën 1,239,565 lekë,

2 kontrata qiraje të lidhura për mbjellje arrorësh në vlerën 694,200 lekë,

21 kontrata për kullotje në vlerën 964,500 lekë.

3 kontrata për shfrytëzimin e mineralit gëlqeror pllakor në vlerën 1,409,162 lekë

2 kontrata për qëllime studimi në vlerën 294,636 lekë

1 kontratë për sipërfaqje ndihmëse dhe ndërtim kantieri në vlerën 34,800 lekë

TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
15	Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit	100,000	-	-

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjores.

Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 100,000 lekë. Ky zë nuk është realizuar pasi mbaroi kontrata 10-vjeçare dhe nuk mund lidhet kontratë e shfrytëzimi për arsye të moratoriumit të pyjeve.

VËRTETIME TRANSPORTI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
16	Vërtetime transporti	70,000	30,000	43 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjores.

Të ardhura nga vërtetime transporti për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 70,000 lekë dhe është realizuar në masën 43 % ose në vlerën 30,000 lekë, vlerë kjo e arkëtuar nga shitja e 10 blloqeve.

PRODHIME TË DYTA MEDICINALE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
17	Prodhime të dyta medicinale	1,000,000	-	-

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjores.

Të ardhura nga prodhime të dyta medicinale për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 1,000,000 lekë dhe gjatë vitit 2024 nuk pati asnjë arkëtim si rezultat i ndryshimit të kuadrit ligjor mbi pyjet dhe mungesës të dispozitave ligjore në zbatim të tij. Si pasojë e këtyre ndryshimeve nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve nuk u bë e mundur lidhja e asnjë kontrate.

GJOBË POLICIA BASHKIAKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
18	Gjobë Policia Bashkiake	1,400,000	346,000	25 %

Gjopa të Policisë Bashkiake për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 1,400,000 lekë realizimi i saj deri në fund të vitit 2024 është në masën 25 % ose në vlerën 346,000 lekë.

Të ardhurat në vlerën 346,000 lekë janë realizuar nga arkëtimi i gjobave të vendosura në subjektet tregtare për shkelje të hapësirave publike në vlerë 49,000 lekë dhe nga arkëtimi i gjobave të vendosura për parkim të gabuar në vlerën 297,000 lekë.

GJOBË PËR VONESË NË PAGESË

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
19	Gjobë për vonesë në pagesë	6,000,000	7,116,472	119 %

Gjopa për vonesë në pagesë për vitin 2024 është planifikuar 6,000,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2024 është në masën 119 % ose në vlerën 7,116,472 lekë. Ky zë është realizuar në vlerën 7,116,472 lekë, konkretisht:

Nga subjektet e biznesit të madh të cilat nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2024 në vlerën 1,470,569 lekë.

Nga subjektet e biznesit të vogël të cilat nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2024 në vlerën 970,580 lekë.

Nga institucionet dhe ojf - të cilat nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2024 në vlerën 16,817 lekë.

Nga pronarët e ndërtesave të cilët nuk i paguan detyrimet brenda afatit të përcaktuar për vitin 2024 në vlerën 276,510 lekë.

Nga familjarët rezidentë efektivë në Njësitë Administrative të cilët nuk i paguan detyrimet e viteve të mëparëshme brenda afateve të përcaktuar në vlerën 781,766 lekë.

Nga debitorët për vitet e mëparëshme për subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh, institucionet - ojf dhe pronarët e ndërtesave në vlerën 3,600,230 lekë.

GJOBË TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
20	Gjobë të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit	200,000	40,000	20%

Gjopa të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitin 2024 u planifikua në vlerën 200,000 lekë dhe është realizuar në masën 20 % kundrejt planifikimit ose në vlerë 40,000 lekë.

GJOBË TË INSPEKTORIATIT NDËRTIMOR VENDOR

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
21	Gjobë të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor	2,500,000	1,572,862	63 %

Gjoha të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 2,500,000 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2024 është në masën 63 % ose në vlerën 1,572,862 lekë. Gjatë vitit 2024 nga ky inspektoriat janë likujduar 24 gjoha në vlerë 1,572,862 lekë.

GJOBË TË DREJTORISË TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
22	Gjoha të D.T.T.V	200,000	180,000	90 %

Gjoha të Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2024 u planifikua në vlerën 200,000 lekë dhe është realizuar në masën 90 % kundrejt planifikimit ose në vlerë 180,000 lekë.

Konkretisht gjatë vitit 2024 janë ushtruar 1639 kontrole nga specialistët e kontrollit dhe mbledhjes së të ardhurave në subjektet akomoduese nga të cilat kanë rezultuar në shkëlqje për mos deklarim dhe është vendosur masa e gjobës për 12 subjekte në vlerë 240,000 lekë. Ky realizim vjen si rezultat i arkëtimit të 5 gjobave nga vitet e mëparshme në vlerën 100,000 lekë dhe 4 gjoha të vitit 2024 në vlerën 80,000 lekë.

QIRA OBJEKTI, QIRA TRUALLI DHE QIRA TOKË BUJQËSORE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
23	Qira objekti, Qira trualli, Qira T. bujqësore e.t.j	9,017,585	9,612,474	107 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Drejtoria Juridike.

Qira objekti, qira trualli, qira tokë bujqësore e.t.j për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 9,017,585 lekë dhe është realizuar në masën 107 % kundrejt planifikimit ose në vlerë 9,612,474 lekë. Konkretisht realizimi i këtij zëri në këtë nivel vjen si rezultat i:

Arkëtimit të 6,649,209 lekë nga zëri qira trualli.

Arkëtimit të 2,863,603 lekë nga zëri qira objekti.

Arkëtimit të 99,662 lekë nga zëri qira tokë bujqësore.

TARIFË PËR LEJET E ZHVILLIMIT (TREGUESIT E NDËRTIMIT)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
24	Tarifë për lejet e zhvillimit (treguesit e ndërtimit)	1,375,000	450,000	33 %

Tarifë për lejet e zhvillimit planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Tarifë për lejet e zhvillimit (treguesit e ndërtimit) për vitin 2024 është planifikuar 1,375,000 lekë dhe është realizuar në masën 33 % ose në vlerën 450,000 lekë.

TARIFË PËR LEJË NDËRTIMI

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
25	Tarifë për leje ndërtimi	700,000	258,000	37%

Tarifë për leje ndërtimi planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Tarifë për leje ndërtimi për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 700,000 lekë realizimi i saj deri në fund të vitit 2024 është në masën 37 % ose në vlerën 258,000 lekë.

TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONË PUBLIKE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
26	Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike	1,339,255	806,101	60 %

Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike planifikohet nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Tarifë për servitutin e kalimit në pronë publike për vitin 2024 është planifikuar 1,339,255 lekë dhe është realizuar në masën 60 % ose në vlerën 806,101 lekë. Realizimi i kësaj tarife vjen si rezultat i arkëtimeve të kryera nga:

34 subjekte që kanë paguar detyrimin për vitin 2024 në vlerën 536,545 lekë me një sipërfaqe prej 399,01 m²

12 subjekte debitore që kanë paguar detyrimet e viteve të mëparëshme gjatë vitit 2024 në vlerën 269,556 lekë me një sipërfaqe prej 186,96 m²

TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESAT SOCIALE)

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
27	Të ardhura nga qiratë (banesa sociale)	7,050,000	8,133,349	115 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Njësia e Menaxhimit të Banesave me qëllim social.

Të ardhurat nga qeratë, (banesa sociale) për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 7,050,000 lekë dhe është realizuar në masën 115 % ose në vlerën 8,133,349 lekë.

TË ARDHURA NGA BANESAT SHETËRORRE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
28	Të ardhura nga banesat shtetërore	84,000	102,333	122 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Njësia e Menaxhimit të Banesave me qëllim social.

Të ardhurat nga banesat shtetërore për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 84,000 lekë dhe është realizuar në masën 122 % ose në vlerën 102,333 lekë.

QIRA NGA BANESAT QË KANË KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
29	Qira nga banesat që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë nga Enti Kombëtar i Banesave	149,144	96,000	64 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Njësia e Menaxhimit të Banesave me qëllim social.

Të ardhurat nga qiratë, (banesa në pronësi të bashkisë enti i banesave) për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 149,144 lekë dhe është realizuar në masën 64 % ose në vlerën 96,000 lekë.

PRIVATIZIM BANESE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
30	Të ardhura nga privatizim banese	2,200,800	2,679,024	122 %

Këto të ardhura planifikohen dhe arkëtohen nga Njësia e Menaxhimit të Banesave me qëllim social.

Të ardhurat nga banesat shtetërore për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 2,200,800 lekë dhe është realizuar në masën 122 % ose në vlerën 2,679,024 lekë.

KAMATË VONESA

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
31	Kamatë vonesa	300,000	232,542	78 %

Kamatë vonesë për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 300,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 232,542 lekë ose në masën 78 % si rezultat i zbatimit të kushteve të kontratës së qiradhënies (1% për çdo ditë vonesë nga afati i përcaktuar në kontratë).

TARIFË PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
32	Tarifë për depozitimin e mbetjeve inerte	6,750,000	1,092,786	16 %

Tarifë për depozitimin e mbetjeve inerte planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 6,750,000 lekë dhe është realizuar në masën 16% ose në vlerën 1,092,786 lekë.

TARIFË VJETORE E MIRËMBAJTJES SË SISTEMIT TË UJITJES

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
33	Tarifë vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes	28,907,078	10,819,688	37%

Tarifa e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes planifikohet dhe arkëtohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Është tarifa që ka kontribuar me 0.9 % të totalit të të ardhurave të realizuara gjatë vitit 2024.

Tarifë vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 28,907,078 lekë dhe realizimi i saj deri në fund të vitit 2024 është në masën 37 % kundrejt planifikimit ose në vlerën 10,819,688 lekë.

Realizimi prej 10,819,688 lekë është arkëtuar i detajuar si më poshtë:

Njësia Administrative Bulgarec ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 1,025,660 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 2,292,410 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Njësia Administrative Drenovë ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 568,412 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 1,030,301 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Njësia Administrative Mollaj ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 383,428 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 635,384 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.


Njësia Administrative Voskop ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 757,737 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 1,005,498 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

Njësia Administrative Korçë ka mundur të arkëtojë gjatë vitit 2024 vlerën prej 461,504 lekë detyrim i vitit korent 2024 dhe vlerën prej 285,327 lekë detyrim ky për periudhën paraardhëse.

abonentët familjarë të Njësive Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë dhe Vithkuq) të cilët kanë kontratë me UKKO dhe kanë kryer pagesat për vitin 2024 në vlerën 2,374,027 lekë

Më poshtë po paraqesim tabelën dhe grafikun me peshën specifike që zë secila nga të ardhurat jo tatimore kundrejt totalit të realizimit për pjesën e të ardhurave jo tatimore për vitin 2024

Nr.	Emërtimi	Në %
B	Të ardhura jotatimore	
1	Tarifë pastrimi	45.8 %
2	Tarifë ndriçimi	13.2 %
3	Tarifë gjelbërimi	8.5 %
4	Tarifë mirmbajtje varreza	3.8 %
5	Tarifë vjetore e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes	3 %
6	Tarifa administrative	1.5 %
7	Të tjera jo tatimore	24.2 %



TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA

Të ardhurat nga taksat e ndara janë planifikuar në nivelin 125,700,000 lekë dhe janë realizuar në nivelin 94,527,102 lekë ose 75 % e planifikimit. Planifikimi në këtë masë ka ardhur si pasojë e planifikimit të agjentëve tatimorë të cilët planifikojnë dhe mbledhin këto të ardhura për llogari të pushtetit vendor. Duke ju referuar treguesve të detajuar të të ardhurave nga taksat e ndara, rritja në raport me një vit më parë është 12.79 % ose e shprehur në shifra 9,737,984 lekë.

Të detajuara paraqiten si më poshtë:

TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
----	----------------------------	------------------	----------------	-----------

1	Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	25,000,000	7,634,433	31 %
---	--	------------	-----------	------

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme e cila planifikohet dhe mblidhet nga agjenti tatimor i cili është ZVRPP Korçë.

Për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 25,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 31 % ose e shprehur në vlerë 7,634,433 lekë. Arkëtimet për këtë taksë kalohen çdo muaj referuar akt-rakordimeve mujore mbi bazën e numrit dhe vlerës të pasurive të paluajtshme objekt transaksioni.

TAKSË E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
2	Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	55,000,000	51,043,386	93 %

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor e cila planifikohet dhe mblidhet nga agjenti tatimor i cili është D.R.SH.T.RR Korçë, për vitin 2024 është planifikuar 55,000,000 lekë dhe është realizuar në masën 93 % ose në vlerë 51,043,386 lekë. Arkëtimet për këtë taksë kalohen çdo muaj referuar akt-rakordimeve mujore mbi numrin e mjeteve dhe vlerën e taksës për çdo mjet.

RENTA MINERARE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
3	Renta minerare	700,000	275,079	39 %

Të ardhura nga renta minerare për vitin 2024 është planifikuar në vlerën 700,000 lekë dhe është realizuar në vlerën 275,079 lekë ose në masën 39 %. Renta minerare arkëtohet në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit ose në rastin e eksportit të produkteve minerare. Baza e taksës janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Struktura e mbledhjes e kësaj takse janë: degët e doganave në rrethe të cilat ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Ky zë është realizuar në vlerën 275,079 lekë, konkretisht nga:

Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në vlerën 141,136 lekë

Drejtoria e Doganave në vlerën 7,569 lekë

Tatimpaguesit e Mëdhenj në vlerën 126,374 lekë


TË ARDHURA NGA TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE

Nr	Lloji i taksës ose tarifës	Planifikimi 2024	Realizimi 2024	Përqindja
4	Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale	45,000,000	35,574,204	79 %

Planifikimi për tatimin mbi të ardhurat personale është bazuar në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 25, pika 2, të ardhurat e arkëtuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë për tatimin mbi të ardhurat personale do të ndahen me njësitë e qeverisjes vendore dhe 2% i të ardhurave nga kjo taksë për pjesën takuese i ka kaluar Bashkisë Korçë. Realizimi në masën 35,574,204 lekë tatim mbi të ardhurat personale përfshin dhe detyrimin për vitet paraardhëse por që kaloi përgjatë vitit 2024.

Më poshtë po paraqesim tabelën dhe grafikun me peshën specifike që zë secila nga taksat e ndara kundrejt totalit të realizimit për pjesën e taksave të ndara për vitin 2024

Nr.	Emërtimi	Në %
C	Taksa të ndara	
1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	8.1%
2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	54%
3	Renta minerare	0.3%
4	Tatim mbi të ardhurat personale	37.6%



3.2 Transferta e pakushtëzuar dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale 2024

Transferta e pakushtëzuar është përdorur për financimin e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara me ligj, ndërsa transferta e pakushtëzuar sektoriale për financimin e funksioneve të transferuara në vitin 2016 si: Arsimi bazë dhe parashkollor, Arsimi i mesëm i përgjithshëm, Konviktet e arsimit parauniversitar,

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, Administrimi i pyjeve dhe kullotave, Ujitja dhe Kullimi dhe Rrugët Rurale, të detajuara sipas tabelës së mëposhtme:


Transferta e pakushtëzuar sektoriale 2021-2024

000/lekë

Transferta e pakushtëzuar sektoriale					
	2021	2022	2023	2024	% e rritjes 2024/2023
Arsimi bazë dhe parashkollor	189,254	194,261	209,891	238,191	113%
Konviktet e arsimit parauniversitar	21,881	22,114	20,413	23,461	115%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	18,838	19,592	24,314	23,132	95%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	29,964	31,163	33,883	38,245	113%
Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	15,197	15,805	17,286	18,075	105%
Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	45,737	47,566	50,300	51,897	103%
Rrjeti rrugor rural	6,521	7,067	7,265	8,094	111%
Total	327,392	337,568	363,352	401,095	110%

Këto funksione kanë pasur një rritje nga viti në vit dhe konkretisht krahasuar me vitin 2023, transferata e pakushtëzuar sektoriale e vitit 2024 ka një rritje prej 10 %.

Paraqitja grafike



Transferta e pakushtëzuar, transferata e pakushtëzuar sektoriale dhe transferata e pakushtëzuar për rritjen e pagave 2021-2024 paraqitet në tabelë dhe grafikisht si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Burimet e financimit	2021	2022	2023	2024	%24/23
1	Transferta e pakushtëzuar	453,082	462,077	550,379	598,629	109%
2	Transferta e pakushtëzuar për rritjen e pagave				53,614	
3	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	327,392	337,568	363,352	401,095	110%
4	Transferta specifike për emergjencat civile	13,691				

	Total	794,165	799,645	913,731	1,053,338	115%
--	--------------	----------------	----------------	----------------	------------------	-------------

Tabela: Transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar për rritjen e pagave, transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe transferta specifike për periudhën 2021-2024



Grafiku: Transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar për rritjen e pagave dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale 2021-2024

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2024 në krahasim me vitin 2023 ka një rritje prej 48,250 mijë lekë ose afërsisht 9%.

Gjatë vitit 2024 Bashkia ka përfutur edhe transfertën e pakushtëzuar për rritjen e pagave, e cila ka qenë në vlerën 53,614 mijë lekë.

3.3 Të ardhurat e Institucioneve të Varësisë 2024

Të ardhurat nga shërbimet që ofrojnë Institucionet e Varësisë u planifikuan në vlerën 38,818 mijë lekë. Këto të ardhura u realizuan në vlerën 22,538 mijë lekë ose në masën 58%.

000/lekë

Institucioni	Plan 2024	Fakt 2024	% e realizimit
Qendra e Artit dhe Kulturës	2,650	2,265	85%
Klubi Shumësportësh	63	32	51%
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	4,055	3,312	82%
Ndërmarrja e Shërbimeve Mbeshtetese e Arsimit dhe Cerdhes	32,000	16,927	53%
Qendra Ditore e Zhvillimit	50	2	4%
Total	38,818	22,538	58%

3.4. Sponsorizimet dhe të ardhura të tjera 2024

Gjatë vitit 2024 Bashkia, Qendra e Artit dhe Kulturës, Klubi Shumësportësh, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, dhe Qendra Rezidenciale e Zhvillimit kanë realizuar disa nga shpenzimet e tyre me të ardhura nga sponsorizimet dhe të ardhura të tjera. Sponsorizimet janë përdorur me të njëjtin destinacion për të cilin janë alokuar. Realizimi paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Institucioni	Sponsorizime /burime të tjera	Fakt
Bashkia+Klubi shumesporetsh	2,450	2,253
Qendra e Artit dhe Kulturës	350	350
Kontributi I qarkut per projektin Rezidenca artistike	3,000	961
Financimi nga TAP	9,371	
Te ardhura UNDP	1,200	1200
Kontributi I qarkut per QRZH	150	150
Kontributi I qarkut per QAK	315	
Rimbursim projekti Includst	4,076	4,076
Total	20,912	8,990

Tabela: Realizimi i sponsorizimeve dhe të ardhurave të tjera 2024

4 ANALIZA E DETAJUAR E SHPENZIMEVE PËR VITIN 2024

Buxheti fillestar vjetor i vitit 2024 ka qenë në vlerën 2,253,270 mijë lekë. Pas ndryshimeve të bëra gjatë vitit nga miratimi me VKB i burimeve nga grande apo financime të ndryshme si dhe nga sponsorizimet, ky buxhet shkoi në vlerën 2,538,490 lekë. Realizimi i buxhetit të vitit 2024 ka qenë 1,938,953 mijë lekë ose realizuar në masën 76%. Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve të buxhetit sipas institucioneve, artikujve buxhetore dhe programeve, paraqitet si më poshtë:

000/lekë

Institucioni	Fakt 2022	Fakt 2023	Buxheti vjetor 2024		Fakt 2024	% e realizimit
			Plan fillestar	Plan përfundimtar		
Bashkia	635,134	685,685	1,009,651	1,174,730	818,953	70%
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	441,631	475,103	577,592	607,888	491,646	81%
Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes	412,557	408,338	502,487	563,188	464,435	82%
Qendra e Artit dhe Kulturës	74,513	79,589	102,916	127,132	107,185	84%
Klubi Shumësportësh	40,720	46,437	54,369	58,793	52,326	89%
Shtëpia e Foshnjës	1,878	1,497	4,355	4,709	2,643	56%
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	412	648	925	1,075	960	89%
Qendra Ditore e Zhvillimit	475	482	975	975	805	83%
Total	1,607,320	1,697,779	2,253,270	2,538,490	1,938,953	76%

Tabela: Realizimi i shpenzimeve të buxhetit të Bashkisë Korçë dhe Institucioneve të Varësisë

Institucionet të cilat kanë bërë të mundur realizimin e buxhetit në nivel të kënaqshëm dhe të qëndrueshëm janë Ndërmarrja e Shërbimeve Publike 81%, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Cerdhes 82%, Klubi Shumësportësh 89%, si dhe Qendra e Artit dhe Kulturës 84%.

000/lekë

Artikulli buxhetor	Fakt 2022	Fakt 2023	Buxheti vjetor 2024		Fakt 2024	% e realizimit
			Plan fillestar	Plan përfundimtar		
Shpenzime për paga (600)	592,172	697,713	800,079	837,180	773,218	92%
Shpenzime për sigurime shoqërore/shëndetësore (601)	99,233	116,664	135,118	141,991	129,086	91%
Shpenzime operative dhe shërbime (602)	579,270	541,484	827,046	879,068	656,767	75%
Subvencione (603)	9,999	10,626	11,342	11,142	10,201	92%
Transferta tek organizatat (604)	111,782	110,710	142,036	154,336	126,827	82%
Transferta tek individët (606)	24,558	17,239	8,940	22,984	15,982	70%
Fondi rezervë + kontigjencës (609)			20,000	20,000		0%
Hartim projektesh dhe oponenca teknike (230)	2506	779	10,000	10,000	3,087	31%
Shpenzime për investime (231)	144,367	162,113	259,609	422,689	187,715	44%
Shpenzime Principali (166)	40,931	37,623	38,000	38,000	35,202	93%
Shpenzime Interesi (651)	2,502	2,828	1,100	1,100	868	79%
Total	1,607,320	1,697,779	2,253,270	2,538,490	1,938,953	76%

Tabela : Realizimi i shpenzimeve sipas artikujve buxhetore

Nga tabela e mësipërme shohim realizimin e buxhetit sipas artikujve buxhetore, ku një përqindje të lartë realizimi kanë shpenzimet e personelit për paga dhe sigurime, subvencioni, shlyerja e kredisë, transfertat tek organizatat, shpenzimet operative dhe shërbimet, të cilat jepen të detajuara përgjatë materialit.

000/lekë

Programet buxhetore		Shpz për personelin (600+601)		Shpz korrente (602-609,166,651)		Shpz kapitale (230-231)		TOTAL		% e realiz
		Plani përfundimtar	Fakt	Plani përfundimtar	Fakt	Plani përfundimtar	Fakt	Plani përfundimtar	Fakt	
Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi	AA122	174,029	163,748	224,923	168,330	56,107	20,601	455,059	352,679	78%
Siguria Publike	AB122	49,135	42,705	14,844	7,059	13,420	6,801	77,399	56,565	73%
Mbështetje e Zhvillimit Ekonomik	AC122	13,746	13,295	31,844	18,260	87,013	32,732	132,603	64,287	48%
Mbrojtja e Mjedisit	AD122	4,339	4,262	193,394	185,123	10,000		207,733	189,385	91%
Shërbime Publike Vendore	AE122	302,124	269,876	295,722	220,354	113,387	68,901	711,233	559,131	79%
Kultura sport dhe argetim	AF122	57,429	49,371	124,755	107,326	3,740	2,814	185,924	159,511	86%
Arsimi bazë dhe parashkollor	AG122	291,746	280,076	165,141	105,810	107,197	35,728	564,084	421,614	75%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	AH122	40,687	39,976	39,363	21,831	25,177	14,806	105,227	76,613	73%
Përkujdesi social	AI122	45,934	38,995	16,645	11,754	16,649	8,419	79,228	59,168	75%
Fondi Rezervë	AJ122			10,000				10,000	0	0%
Fondi i Kontigjencës	AK122			10,000				10,000	0	0%
TOTAL - BASHKIA	TOTAL	979,169	902,304	1,126,631	845,847	432,690	190,802	2,538,490	1,938,953	76%

Tabela: Realizimi i shpenzimeve sipas programeve buxhetore



Në tabelën e mësipërme paraqitet realizimi i buxhetit sipas programeve buxhetore, ku përqindjen më të lartë të realizimit e kanë programet si: Mbrojtja e Mjedisit 91%, Kultura, Sport dhe Argëtimi 86%, Shërbimet Publike

Vendore 79%, Planifikim, menaxhim, administrim 78%, Arsimi bazë dhe parashkollor dhe Përkujdesi Social 75% etj. Analiza e detajuar e buxhetit sipas programeve dhe funksioneve që kryejnë jepet si më poshtë:

5 ANALIZA E SHPENZIMEVE BASHKIA

Bashkia ka buxhetuar dhe realizuar 10 programe, të cilat do të jepen përgjatë materialit. Ky buxhet ka qenë i planifikuar në vlerën 1,174,730 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 818,952 mijë lekë ose në masën 70 %. Realizimi në përqindje sipas natyrës së shpenzimeve ka qenë:

- Shpenzime personeli: 92%
- Shpenzime korrente: 78 %
- Shpenzime për investime: 41 %

Ky buxhet paraqitet i detajuar sipas programeve dhe sipas natyrës së shpenzimeve si më poshtë:

000/lekë

Programet buxhetore		Shpz për personelin (600+601)		Shpz korrente (602-609,166,651)		Shpz kapitale (230-231)		TOTAL		% e realiz
		Plani përfundimtar	Fakt	Plani përfundimtar	Fakt	Plani përfundimtar	Fakt	Plani përfundimtar	Fakt	
Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi	AA122	174,029	163,748	224,923	168,330	56,107	20,601	455,059	352,679	78%
Siguria Publike	AB122	49,135	42,705	14,844	7,059	13,420	6,801	77,399	56,565	73%
Mbështetje e Zhvillimit Ekonomik	AC122	13,746	13,295	31,844	18,260	87,013	32,732	132,603	64,287	48%
Mbrojtja e Mjedisit	AD122	4,339	4,262	193,394	185,123	10,000		207,733	189,385	91%
Shërbime Publike Vendore	AE122	1,562	1,556	15,000	13,981	86,782	51,948	103,344	67,485	65%
Arsimi bazë dhe parashkollor	AG122			900	853	80,760	18,332	81,660	19,185	23%
Arsimi i mesëm i përgjithshëm	AH122			560	275	23,903	14,332	24,463	14,607	60%
Përkujdesi social	AI122	41,229	35,673	14,852	10,667	16,388	8,419	72,469	54,759	76%
Fondi Rezervë	AJ122			10,000				10,000	0	0%
Fondi i Kontigjencës	AK122			10,000				10,000	0	0%
TOTAL - BASHKIA	TOTAL	284,040	261,239	516,317	404,548	374,373	153,165	1,174,730	818,952	70%

Tabela: Shpenzimet sipas programeve dhe llogarive ekonomike për Bashkinë Korçë

Fondi i planifikuar për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2024 ka qenë në vlerën 284,040 mijë lekë dhe realizimi 261,239 mijë lekë ose realizuar në masën 92 %.

Numri i punonjësve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2024 ka qenë 1,122, i detajuar si më poshtë:

Institucionet	Viti 2024
Bashkia	232
Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi	29
Shërbimi i Administrimit të Pyjeve	15
Qendra e Artit dhe Kulturës	49
Klubi Shumësportësh	15
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	392

Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes	385
Qendra e Zhvillimit Ditor	1
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	1
Shtëpia e Foshnjës	3
Total	1,122

Fondi i planifikuar për shpenzime korrente për vitin 2024 ka qenë në vlerën 516,317 mijë lekë dhe realizimi 404,548 mijë lekë ose realizuar në masën 78%. Tek ky fond janë përfshirë shpenzimet operative, shpenzime mirëmbajtjeje, shpenzime për realizimin e projekteve, shërbimi i pastrimit, shërbimi urban, shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve, transfertat për organizata të ndryshme, transfertat për individët, pagesa për principalin dhe interesin e kredisë, si dhe fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.

Të gjitha këto shpenzime do të jepen të detajuara në nivel produkti përgjatë materialit.

Fondi i planifikuar për investime në vitin 2024 ka qenë 374,373 mijë lekë dhe realizimi ka qenë 153,165 mijë lekë ose në masën 41%.

Pjesë përbërëse e realizimit të buxhetit të Bashkisë janë dhe aktivitetet, për të cilat po paraqesim të detajuar, një përshkrim të shkurtër të shoqëruar me foto dhe fondin e realizuar.

/lekë

TABELA E AKTIVITETEVE 2024

Nr.	Emri i projektit	Plan 2024	Fakt 2024
1	Korça Snow Fest	3,000,000	0
2	Ballkan Fest	1,500,000	1,273,744
3	Çelja e sezonit turistik (koncerte live)	2,000,000	0
4	Rock Festival	5,000,000	3,490,523
5	Spring Festival	3,784,000	3,325,235
6	Korca Electronic Beat	1,000,000	1,000,000
7	Time Travel Voskopoja	500,000	0
8	Christmas & Lights Festival	3,500,000	3,305,876
9	Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare të turizmit	500,000	300,000
10	Festivali i Serenatës	1,000,000	1,000,000
11	Festa e Lakrorit	336,000	316,000
12	Festa e Dardhës	224,000	224,000
13	Festa e Mollës	160,000	160,000
14	Fly Korça (Aeronautika Shqiptare)	870,000	759,520
15	Marketing në rrjetet sociale ndërkombëtare	500,000	0
16	Pjesëmarrje në Panairin e turizmit "ITB Berlin"	0	0
17	Pjesëmarrje në Panairin "PHILOXENIA HOTELIA"	0	0
	TOTALI	23,874,000	15,154,898

AKTIVITETE PROGRAME TE TJERA			
1	Festa e Mësuesit	700,000	562,800
2	Dita ndërkombëtare e gruas 8 Mars	400,000	324,000

3	9 Maj, Dita e Europës	180,000	120,000
4	Rrënjët e qytetit tim	190,000	115,000
5	Bursat për gjimnazistët ekselentë	4,654,000	3,006,900
	TOTALI (Lekë)	5,934,000	4,128,700

Një informacion i detajuar i aktiviteteve që janë realizuar gjatë vitit 2024

🇫🇮 Dita Ndërkombëtare e Gruas, 8 Marsi

Në kuadër të “Ditës Ndërkombëtare të Gruas”, datë 8 Mars, Bashkia Korçë shpërndau një sasi lulësh natyrale (trëndafil) në qytet për të gjitha vajzat dhe gratë, në shenjë mirënjohje për dashurinë dhe përkushtimin që vajzat dhe gratë falin çdo ditë, si dhe vlerësim ndaj rolit të pazëvendësueshëm të tyre në shoqëri.



Vlera e planifikuar e projektit: 400,000 Lekë

Vlera e realizuar: 324,000 Lekë

🇫🇮 9 Maj, Dita e Europës

Në kuadër të 9 Majit, ditës së Europës Bashkia Korçë në bashkëpunim me shkollën “Asdreni” organizuan në ambientet e Qendrës së Mikpritjes dhe Inovacionit (MIK) një koncert të bukur artistik me pjesëmarrjen e nxënësve të talentuar të kësaj shkolle. Me shumë përkushtim dhe përgjegjshmëri nxënësit ndërthurën forma të ndryshme të artit për të përcjellë mesazhin e Europës së bashkuar.



Vlera e planifikuar e projektit: 180,000 Lekë

Vlera e realizuar: 120,000 Lekë

✚ Rrënjët e qytetit tim

Në kuadër të projektit “Rrënjët e qytetit tim”, i cili kishte si qëllim identifikimin e objekteve të rëndësishme kulturore, historike dhe arkitekturore të qytetit të Korçës dhe krijimin e një ekspozite fotografike me to, për të ndërgjegjësuar brezin e ri dhe për të theksuar rëndësinë e vlerave të tyre në jetën e përditshme, Bashkia Korçë organizoi këtë projekt me nxënës të shkollave të ndryshme të qytetit të Korçës. Tek ambientet e universitetit “Fan. S. Noli” u ekspozuan punimet e nxënësve fotografi në forex, të cilat promovonin vlerat e qytetit. Ekspozita ishte pjesë e një ore leksioni të hapur për bashkimin Europian, procesin e integritetit dhe projektet e financuara. Në fund të gjithë vizituan ekspozitën me fotografi të nxënësve, si dhe zhvilluan diskutime të lira rreth fotografive të ekspozuara. Ishte një aktivitet, i cili la shije pozitive tek të gjithë të pranishmit.



Vlera e planifikuar e projektit: 190,000 Lekë

Vlera e realizuar: 115,000 Lekë

✚ Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare

Bashkia Korçë u prezantua në datat 31 Janar-1 Shkurt 2024 në Pallatin e Kongreseve, Tiranë në Panairin “Tourism & Travel Show Albania” me stendën Nr.47 me sipërfaqe 20m², ku shpalosi potencialin turistik që Korça ofron për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj. Stenda e Bashkisë Korçë prezantohet me logon e re “Korça, The Heartland” dhe prezantonte përveç atraksioneve turistike edhe eventet e reja turistike, të cilat do të zhvillohen përgjatë vitit 2024, si edhe projekte të tjera të rëndësishme, si Galeria e Arteve Dixhitale, e para e këtij lloji në Shqipëri. Prezantimi i potencialit turistik që ofron Korça pati interes të madh jo vetëm nga vizitorët vendas dhe të huaj, të cilët vizituan panairin, por pati interes edhe nga tour operatorë vendas dhe të huaj.



Vlera e planifikuar e projektit: 500,000 Lekë

Vlera e realizuar: 300,000 Lekë

Spring Festival

Bashkia Korçë realizoi projektin “Korça Spring Festival” përgjatë 9 ditëve të fundjavave të muajit Maj (datat 4,5,6,10,11,12,17,18,19 Maj) në dy stage të instaluar në Pazarin e Vjetër Korçë dhe Zonën Këmbësore të qytetit.

Aktiviteti “Korça Spring Festival” ofroi përgjatë gjithë fundjavave të muajit maj 2024, në dy zonat më të frekuentuara në qytet një kalendar shumë të pasur performancash muzikore live nga këngëtarë dhe banda muzikore të njohura, DJ, të cilat gjallëruan atmosferën festive gjatë stinës së pranverës, duke krijuar argëtim për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj që vizitojnë qytetin.



Vlera e planifikuar e projektit: 3,784,000 Lekë

Vlera e realizuar: 3,325,235 Lekë

Ballkan Fest

Në datat 24 dhe 25 maj Bashkia Korçë realizoi projektin “Ballkan Fest”, e cila përfshinte realizimin e performancave artistike të grupeve folklorike ballkanike në Zonën Këmbësore të qytetit të Korçës dhe në datë 25 maj kulmuan me performancat e tyre tek Pazari i Vjetër Korçë, duke ofruar argëtim për të gjithë banorët, vizitorët vendas dhe të huaj.



Vlera e planifikuar e projektit: 1,500,000 Lekë

Vlera e realizuar: 1,273,744 Lekë

Rock Festival

Bashkia Korçë organizoi përgjatë 3 ditëve të fundjavës të muajit Qershor (datat 21,22,23 Qershor 2024) në Sheshin perpara Katedrales aktivitetin "Rock Festival", me mbështetjen e "Riders Legends Korça". Aktiviteti u zhvillua në sheshin para Katedrales "Ringjallja e Krishtit" dhe në të morën pjesë mbi 300 motoristë të apasionuar nga Shqipëria dhe nga vende të tjera si Kosova, Maqedonia e Veriut, Greqia, etj. Ky aktivitet u shoqërua me performancat muzikore rock live të bandave më të mira muzikore "Offchestra", "Rubin Kaso & Band", Grupi "Burn", Erina Seitllari Band. Aktiviteti "Rock Festival", ofroi përgjatë tre mbëmjeve në një nga zonat më të frekuentuara në qytet një kalendar shumë të pasur mbrëmjesh me performanca të shkëlqyera muzikore live, nga këngëtarë dhe bandat muzikore më të njohura të rrymës rock në Shqipëri.

Aktiviteti gjallëroi atmosferën festive gjatë gjithë ditëve, duke krijuar mundësi argëtimi për të gjithë banorët e Korçës, vizitorët vendas dhe të huaj, që kishin erdhur në Korçë gjatë fundjavës, si edhe motoristët e ftuar nga Shqipëria dhe jashtë saj nga Greqia, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, etj, për të gjithë të apasionuarit pas motorave, të cilët frekuentuan aktivitetin, si dhe u njohën më tepër me markat më të njohura të mjeteve motorike të ekspozuara në sheshin e aktivitetit.



Vlera e planifikuar e projektit: 5,000,000 Lekë

Vlera e realizuar: 3,490,523 Lekë

Korça Electronic Beat

Bashkia Korçë organizoi prej datës 19 deri në datë 20 Korrik 2024 tek Parku Rinia aktivitetin "Korça Electronic Beat", një aktivitet i veçantë muzikor, i cili përfshin një spektakël të ndriçimit, projektionit dhe muzikës elektronike me artistët më të njohur ndërkombëtarë. Aktiviteti përgjatë dy mbrëmjeve filloi në mbrëmje dhe zgjati deri në orët e para të mëngjesit dhe u frekuentua nga banorë të Korçës, si dhe shumë vizitorë vendas dhe të huaj, që vizitojnë Korçën gjatë fundjavës dhe që e pëlqejnë shumë muzikën elektronike me performancat më të mira muzikore të DJ-ve më të njohur vendas dhe të huaj.




Vlera e planifikuar e projektit: 1,000,000 Lekë

Vlera e realizuar: 1,000,000 Lekë

Festa e Lakrorit

Bashkia Korçë organizoi në datën 3 Gusht 2024, Ora 19:00 në Polenë aktivitetin "Festa e Lakrorit", i cili kishte për qëllim promovimin e vlerave tradicionale të artit të kulinarisë..

Aktiviteti "Festa e Lakrorit" u frekuentua dhe u mirëprit nga shumë vizitorë vendas dhe të huaj, të cilët kishin erdhur në Polenë gjatë fundjavës, për të provuar shijen e lakrorit tradicional të pjekur në saç të përgatitur nga amvisat e Polenës, ku nuk mungonte shija e veçantë, muzika e vallet popullore, por edhe argëtimi për fëmijët.



Vlera e planifikuar e projektit: 336,000 Lekë

Vlera e realizuar: 316,000 Lekë

Festa e Dardhës

Festa e Dardhës, një nga ngjarjet më të rëndësishme të vitit është një moment i veçantë për banorët e Dardhës, që kanë dhënë kountributin për ta bërë Dardhën destinacionin më të bukur të gjithë Shqipërisë, që mbart me vete një histori të pasur, kulturë të thellë dhe tradita të ruajtura me dashuri ndër shekuj. Aktiviteti "Festa e Dardhës" pati pjesëmarrje të gjerë nga banorët e Dardhës, qytetarët e Korçës, vizitorët vendas dhe të huaj që vizitojnë Korçën gjatë javës, të cilët shijuan jo vetëm natyrën e bukur që ofron Dardha, por edhe për t'u argëtuar përmes programit artistik të përgatitur me rastin e 400- vjetorit të themelimit të fshatit Dardhë, i cili është një moment i veçantë historik për banorët e Dardhës.



Vlera e planifikuar e projektit: 224,000 Lekë

Vlera e realizuar: 224,000 Lekë

Festivali i Serenatës

Festivali Ndërkombëtar i Serenatës çeli në datat 27 dhe 28 Shtator 2024 tek Pazari i Vjetër Korçë edicionin e parë për t'u kthyer në një traditë të përvitshme, si një nga festivalet më të rëndësishme të kalendarit vjetor të Korçës. Nata e parë e Festivalit Ndërkombëtar të Serenatës në Korçë mbushi qytetin me tingujt magjepsës të kitarave dhe këngëve të dashurisë, duke krijuar një atmosferë të paharrueshme për qindra vizitorë. Ndërkohë nata e dytë e festivalit e shndërroi Korçën në një nga pikat më të rëndësishme kulturore të Shqipërisë që vazhdon të dhurojë emocion dhe art. Ky festival synon ta sjellë serenatën korçare në dy versione, atë tradicionalin dhe të përpunuarin. Organizimi i një festivali dedikuar serenatave, synon që të tërheqë më shumë turistë jashtë sezonit të lartë turistik dhe njëkohësisht të ruajë dhe kultivojë vlerat e serenatës, si një pasuri kulturore e këtij qyteti, që promovon dhe ruan trashëgiminë kulturore dhe e transmeton atë tek brezat e rinj.



Vlera e planifikuar e projektit: 1,000,000 Lekë

Vlera e realizuar: 1,000,000 Lekë

Festa e Mollës

Bashkia Korçë organizoi në datën 23 Tetor 2024, në Dvoran projektin “Festa e Mollës”, i cili kishte për qëllim promovimin e prodhimeve të Korçës si dhe produkteve bujqësore të zonave rurale të Korçës, me qëllim rritjen e

zhvillimit ekonomik të fermerëve të Dvoranit dhe zonave përreth. Të pranishmit në aktivitet u prezantuan me të gjitha varietetet e mollëve që rriten në fshatin Dvoran nga fermerët e zonës. Gjatë aktivitetit kishte dhe shume produkte të tjera që baza e prodhimit të tyre ishte molla. Aktiviteti “Festa e Mollës” u frekuentua deri në orët e vona të mbrëmjes edhe nga shumë vizitorë vendas dhe të huaj, të cilët po shijonin dhe muzikën e luajtur nga DJ Eni me këngë popullore dhe ato modern, ku i dhanë mbrëmjes ngjyrat e duhura për një festë.



Vlera e planifikuar e projektit: 160,000 Lekë

Vlera e realizuar: 160,000 Lekë

Christmas & Light Festival

Gjatë muajit Dhjetor deri në ditët e para të muajit janar 2025 Bashkia Korçë zhvilloi projektin Christmas & Light Festival e cila përfshinte koncerte dhe performanca muzikore live përgjatë Krishtlindjes dhe festave të fundvitit në qendër të qytetit dhe Pazarin e Vjetër Korçë. Aktiviteti “Christmas & Light Festival”, është event i më i veçantë, i cili tashmë zhvillohet çdo vit në fundvit nga Bashkia Korçë dhe përmes performancave më të mira muzikore live, të cilat gjallërojnë atmosferën në qytet, tërheqin vëmendjen e gjithë grupmoshave, qytetarëve të Korçës, por sidomos vizitorëve vendas dhe të huaj, që kanë zgjedhur Korçën për të festuar e argëtuar në Krishtlindje dhe Vitin e Ri. Organizimi i aktiviteteve muzikore në Korçë është një iniciativë e rëndësishme, që kontribuon në promovimin e kulturës lokale dhe zhvillimin e turizmit. Korça, përmes këtyre aktiviteteve dhe eventeve të organizuara gjatë vitit, tashmë është kthyer në kryeqytetin e festave të vizitorëve vendas dhe të huaj.



Vlera e planifikuar e projektit: 3,500,000 Lekë

Vlera e realizuar e projektit: 3,305,876 lekë

Fly Korça

Bashkia Korçë zhvilloi prej datës 14 deri në datën 16 Dhjetor 2024 projektin “Kampionatin e Fluturimeve të Lira”, një eveniment i organizuar çdo vit gjatë muajit Dhjetor me mbështetjen e Federatës Shqiptare të Aeronautikës. Në aktivitetin tre ditor morën pjesë 40 pilotë profesionistë nga vende të ndryshme të botës, gjatë të cilit u zhvillua gara në disiplinën “Preçizion” në edicionin e 12- të Kampionatit Kombëtar.

Kampionati i Fluturimeve të lira, tashmë është kthyer prej shumë vitesh në traditë për Korçën, jo vetëm si një aktivitet sportiv por edhe si një promovim i shkëlqyer për krejt rajonin.



Vlera e planifikuar e projektit: 870,000 Lekë

Vlera e realizuar: 759,520 Lekë

Festa e Mësuesit

Për realizimin e Festës së Mësuesit datë 7 mars, Bashkia Korçë organizoi një pritje për mësuesit në pension në ambientet e teatrit “Andon Z. Çajupi”. Për të gjithë mësuesit në pension të ftuar në aktivitet, në shenjë urimi dhe mirënjohje, u shpërnda një dhuratë simbolike, penë e vendosur në kuti të personalizuar. Në fund të fjalës përshëndetëse të Kryetarit të Bashkisë, mësuesit festuan së bashku, duke kujtuar mes miqsh vitet e bukura të punës së tyre me shumë përkushtim e dashuri.



Vlera e planifikuar e projektit: 700,000 Lekë

Vlera e realizuar: 562,800 Lekë

Bursa për gjimnazistët

Bashkia Korçë realizoi projektin “Bursa për gjimnazistët”, nga e cila përfituan 65 nxënës të shkollave publike dhe jopublike të Bashkisë Korçë. Aktiviteti u zhvillua në datë 12 Dhjetor 2024 në ambientet e Galerisë Dixhitale. Të pranishëm në këtë aktivitet ishte dhe Kryetari i Bashkisë Korçë Z. Sotiraq Filo, i cili përgëzoi nxënësit për arritjen e tyre në rezultate të shkëlqyera përmes shpërndarjes së certifikatave. Aktiviteti vijoi me ndarjen e certifikatave ku të pranishëm ishin dhe drejtorët e gjimnazeve, nxënësit përfitues, si dhe prindërit e tyre. Pjesë e këtij aktiviteti ishte performanca muzikore në violinë dhe piano e dy nxënësve ekselentë dhe të talentuar të shkollës së mesme artistike “Tefta Tashko Koço”.



Vlera e planifikuar e projektit: 4,654,000 Lekë

Vlera e realizuar: 3,006,900 Lekë

EVENTE TË RËNDËSISHME TURISTIKE 2024 KU KA MARRË PJESË BASHKIA KORÇË:

Panairi i turizmit “ITB Berlin 2024”, (Berlin 5-7 Mars 2024)

Korça prezantoi ofertën e saj turistike në panairin më të madh të turizmit në botë “ITB Berlin 2024”, i cili u zhvillua nga data 5 deri në datën 7 Mars 2024 në Berlin, Gjermani. Në edicionin e këtij viti, në panairin e Berlinit Shqipëria ishte ekspozues kryesor dhe mori pjesë me një koncept të ri promovimi, me një ekip prej 26 operatorësh turistikë dhe 8 bashki turistike, që prezantuan në mënyrë gjithëpërfshirëse nën sloganin “Albania All Senses” potencialet, atraksionet dhe tregun shqiptar të turizmit. Korça si një ndër bashkitë kryesore të vendit, bashkëekspozues në stendën e Shqipërisë prezantoi një trashëgimi të pasur kulturore, bukuri mahnitëse natyrore dhe përvojë gjithëpërfshirëse, duke i ftuar vizitorët të nisin një udhëtim të paharrueshëm drejt destinacionit turistik më të bukur në Shqipëri. Kryetari i Bashkisë Korçë së bashku me Zv/Kryetarin përgjegjës për çështjet e turizmit, prezantuan më të mirën e ofertës turistike dhe etnografike të Korçës në stendën shqiptare si edhe theksuan gjatë takimit me organizatorët gjermanë rëndësinë e 5 shtyllave kryesore ku bazohet turizmi në Korçë, natyra, kultura dhe trashëgimnia kulturore, eventet e mëdha ndërkombëtare, e veçantitë e Korçës dhe gastronomia. Përfaqësues të Bashkisë Korçë në këtë panair ishin kryetari i Bashkisë Korçë, Z. Sotiraq Filo, dhe Zv/Kryetarja e Bashkisë Korçë Znj. Benila Themeli, të cilët së bashku me Ministren e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro, ftuan operatorët turistikë ndërkombëtarë të përfshijnë në paketat e tyre edhe Korçën, si një nga destinacionet më të bukura dhe më të vlefshme në Shqipëri. Gjatë ditëve të zhvillimit të panairit në stendën e

Shqipërisë u publikua video turistike e rajonit të Korçës si edhe një video e etnografisë dhe vlerës që mbartin dhe transmetojnë shumëllojshmëria e kostumeve popullore të rajonin.



🇪🇺 Panairi “PHILOXENIA HOTELIA”, (Selanik 14-16 Nëntor 2024)

Korça mori pjesë në Panairin “PHILOXENIA HOTELIA”, i cili u zhvillua prej datës 14 deri në datën 16 Nëntor 2024, në Qendrën Ndërkombëtare të Ekspozitave dhe Kongreseve në Selanik, Greqi. Prezantimi zyrtar i Rajonit të Korçës në Panairin “Philoxenia” në panari u bë përmes një prezantimi prestigjioz dhe një program të veçantë në datën 16 Nëntor 2024 Ora 14:00- 16:00. Interesi i madh për paketën turistike të qarkut të Korçës tregon se potenciali i rajonit po njihet dhe vlerësohet gjithnjë e më shumë. Kombinimi i historisë, kulturës dhe natyrës unike e bën Korçën një destinacion tërheqës për turistët nga e gjithë bota. Krijimi i kontakteve me operatorët turistikë është një hap kyç për zgjerimin e ofertës turistike dhe sjelljen e më shumë vizitorëve në Korçë. Bashkëpunimi i ngushtë me ta mund të ndihmojë në zhvillimin e tureve të personalizuara, promovimin ndërkombëtar dhe organizimin e eventeve speciale që mund të tërheqin turistë të ndryshëm gjatë gjithë vitit. Panairi pret vizitorë të rëndësishëm ndërkombëtarë, duke u dhënë të gjithëve mundësinë e kontaktit të drejtpërdrejtë dhe bashkëpunimit me profesionistë të biznesit global të turizmit.



6 DETAJIMI I BUXHETIT TË BASHKISË SIPAS PROGRAMEVE

Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2024 u planifikua dhe realizua sipas 10 programeve, të cilat përfshijnë 26 funksionet që menaxhohen nga Bashkia.

Detajimi i shpenzimeve sipas programeve dhe produkteve do të paraqitet si më poshtë:

6.1 Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi – AA122

Në këtë program përfshihen funksioni i planifikimit, menaxhimit dhe administrimit, çështjet financiare dhe fiskale, planifikimi urban vendor, gjendja civile, pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm si dhe kontributi i Bashkisë për QSK dhe Klubet e Futbollit.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për periudhën janar - dhjetor 2024 ka qenë 352,681 mijë lekë ose realizuar në masën 78% kundrejt planit vjetor të vitit 2024, në vlerën 455,058 mijë lekë dhe krahasuar me realizimin e vitit 2023 ka një rritje prej 14.7%.

Fondi i planifikuar për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2024 ka qenë 174,028 mijë lekë dhe realizimi 163,749 mijë lekë ose 94%. Fondi i planifikuar për shpenzime korrente për vitin 2024 ka qenë 224,923 mijë lekë dhe realizimi 168,331 mijë lekë ose 75%. Fondi i planifikuar për shpenzime për investime ka qenë 56,107 mijë lekë dhe realizimi 20,601 mijë lekë, ose 37%.

Tabela e raportimit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore jepet si më poshtë:

000/lekë

Programi	Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi					Kodi i Programit		AA122	
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit paraardhës 2023	PBA Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plani i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Fakti i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Diferenca	% e realizimit
600	Paga	120,016	147,583	147,583	149,658	149,658	140,485	-9,173	94%
601	Sigurime Shoqërore	19,870	25,100	25,100	24,370	24,370	23,264	-1,106	95%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	45,865	75,677	75,677	76,252	76,252	47,728	-28,524	63%
604	Transferta Korrente të Brendsh	72,728	91,631	91,631	108,846	108,846	83,808	-25,038	77%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	273			725	725	725	0	100%
166	Shpenzime për principalin	37,623	38,000	38,000	38,000	38,000	35,202	-2,798	93%
651	Shpenzime për interesin	2,828	1,100	1,100	1,100	1,100	868	-232	79%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	299,203	379,091	379,091	398,951	398,951	332,080	-66,871	83%
230	Kapitale të Patrupëzuara	659	10,000	10,000	10,000	10,000	3,087	-6,913	31%
231	Kapitale të Trupëzuara	7,572	23,352	23,352	46,107	46,107	17,514	-28,593	38%
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale	8,231	33,352	33,352	56,107	56,107	20,601	-35,506	37%
Totali (korrente + kapitale)		307,434	412,443	412,443	455,058	455,058	352,681	-102,377	78%

Ky program ka buxhetuar dhe realizuar shpenzimet dhe shërbimet sipas 16 produkteve të përcaktuara sipas metodologjisë së përgatitjes së buxhetit.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve sipas produkteve dhe llogarive ekonomike:

000/lekë

Produktet/Shpenzimet	V111AAA - Shërbimi i Administrim & Menaxhim	V614AAB - Inspektime të zhvilluara për mbrojtjen e territorit	V112AAB - Subjekte tregtare të Inspektuara	V111AAD - Mirëmbajtja e Infrastrukturaës dhe Funksionimi i Aparatit të Bashkisë	V111AAH - Nëpunës të trajnuar	V111AAG - Përbushja e Detyrimeve Gjyqësore	V360AAA - Transparenca publike	V111AAB - Akte të miratuara nga Këshilli Bashkiak	V171AAB - Paga e shërbimit të borxhit	V111AAJ - Kuota dhe kontribute ndaj të tretëve	V813AAE - Financimi për Qendra Sportive Korçë	V813AAC - Financimi për Klubet e Futbollit	V614AAC - Projekte të hartuara dhe monitoruara	P614AAB - Shpronësim varrezat publike dhe investime të ndryshme	P111AAA - Mirëmbajtja dhe përmirësim e infrastrukturës fizike të Bashkisë	P813AAJ - Rehabilitimi i Qendres Rinore Korçë	Total
PI 600	86,930	15,086	47,643														149,659
Fakt 600	79,725	13,278	47,482														140,485
PI 601	13,930	2,473	7,967														24,370
Fakt 601	13,129	2,217	7,918														23,264
PI 602	5,415	300	4,694	36,984	4,588	10,635	3,892	9,744									76,252
Fakt 602	5,398		1,597	24,241	3,723	2,236	2,222	8,311									47,728
PI 604									22,902	47,194	38,750						108,846
Fakt 604									6,814	40,950	36,045						83,809
PI 606	295	156							274								725
Fakt 606	295	156							274								725
PI 230												10,000					10,000
Fakt 230												3,087					3,087
PI 231				25,721								1,700	17,367	5	1,313		46,106
Fakt 231				16,662										5	847		17,514
PI 166								38,000									38,000
Fakt 166								35,202									35,202
PI 651								1,100									1,100
Fakt 651								868									868
Total PI AA122	106,570	18,015	60,304	62,705	4,588	10,635	3,892	9,744	39,100	23,176	47,194	38,750	11,700	17,367	5	1,313	455,058
Total Fakt AA122	98,547	15,651	56,997	40,903	3,723	2,236	2,222	8,311	36,070	7,088	40,950	36,045	3,087	-	5	847	352,682
% e realizimit	92%	87%	95%	65%	81%	21%	57%	85%	92%	31%	87%	93%	26%	0%	100%	65%	78%

Produktet me realizim të mire janë: Shërbimi I stafit të administrim dhe menaxhimit 92%, subjekte tregtare të licensuara 95%, financimi për klubet e futbollit 93%, pagesa e shërbimit të borxhit 92%.

6.2 Siguria Publike – AB122

Ky program përfshin administrimin e çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse, parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vijnë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për periudhën janar-dhjetor 2024 ka qenë 56,565 mijë lekë ose realizuar në masën 73%, kundrejt planit vjetor të vitit 2024, në vlerën 77,399 mijë lekë dhe krahasuar me realizimin e vitit 2023 ka një rritje prej 19%.

Fondi i planifikuar për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2024 ka qenë 49,135 mijë lekë dhe realizimi 42,705 mijë lekë ose 87%. Fondi i planifikuar për shpenzime korrente për vitin 2024 ka qenë 14,844 mijë lekë dhe realizimi 7,059 mijë lekë ose 48%. Fondi i planifikuar për shpenzime për investime ka qenë 13,420 mijë lekë dhe realizimi 6,801 mijë lekë, ose 51%.

Planifikimi dhe realizimi i programit AB122 sipas llogarive ekonomike jepet sipas tabelës më poshtë:

Programi	Siguria Publike					Kodi i Programit		AB122	
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit paraardhës 2023	PBA Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plani i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Fakti i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Diferenca	% e realizimit
600	Paga	33,258	40,052	40,052	41,929	41,929	36,623	-5,306	87%
601	Sigurime Shoqërore	5,559	6,715	6,715	7,206	7,206	6,082	-1,124	84%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4,811	7,574	7,574	8,629	8,629	6,459	-2,170	75%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,934	3,000	3,000	6,215	6,215	600	-5,615	10%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	45,562	57,341	57,341	63,979	63,979	49,764	-14,215	78%
231	Kapitale të Trupëzuara	1,960	1,500	1,500	13,420	13,420	6,801	-6,619	51%
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale	1,960	1,500	1,500	13,420	13,420	6,801	-6,619	51%
Totali (korrente + kapitale)		47,522	58,841	58,841	77,399	77,399	56,565	-20,834	73%

Ky program ka buxhetuar dhe realizuar shpenzimet dhe shërbimet sipas 4 produkteve të përcaktuara sipas metodologjisë së përgatitjes së buxhetit.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve sipas produkteve dhe llogarive ekonomike :

000/lekë

Produktet/Shpenzimet	V314AAB-Patrullim për sigurinë publike	V328AAB-Shërbime të mbrojtjes civile	V328AAC-Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit	V091AAD-Familje të dëmshpërblyera për dëme nga zjarri	Total
PI 600	11,622	30,307			41,929
Fakt 600	10,174	26,449			36,623
PI 601	1,945	5,262			7,207
Fakt 601	1,699	4,383			6,082
PI 602	3,055	1,055	4,519		8,629
Fakt 602	1,864	1,055	3,540		6,459
Plan 606		216		5,999	6,215
Fakt 606		216		384	600
PI 231	1,500	11,920			13,420
Fakt 231	1,440	5,361			6,801
Total PI AB122	18,122	48,760	4,519	5,999	77,400
Total Fakt AB122	15,177	37,464	3,540	384	56,565
% e realizimit	84%	77%	78%	6%	73%

Produktet me realizim të mirë janë: Patrullim për sigurinë publike 84%, si dhe raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit 78%.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të detajuara shpenzimet operative vetëm për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, (funksion i financiar nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale), ndërsa shpenzimet operative për funksionin e policisë bashkiake jepen të detajuara në tabelën e shpenzimeve operative përmbledhëse të Bashkisë.

000/lekë

Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve korrente	Realizimi 2023	PI 2024	Realizimi 2024	Diferencë	% e realizimit	Real2024/real2023
1	Pagesë uji	114	280	91	189	33%	80%
2	Karburant makina	490	625	482	143	77%	98%
3	Shpenzime Interneti	9	48	40	8	83%	444%
4	Shërbime postare	8	10	10	-	100%	125%
5	Meremetim dhe lyerje ambienti MZSH	184					0%
6	Dru zjarri për ngrohje		230	188	42	82%	
7	Siguracion mjeteve transporti	245	326	243	83	75%	99%
8	Energji elektrike	262	362	361	1	100%	138%
9	TVMP dhe SGS	190	340	163	177	48%	86%
10	Materiale elektrike	15	15	11	4	73%	73%
11	Materiale pastrimi	27	35	29	6	83%	107%
12	Materiale hidrosanitare	17	25	15	10	60%	88%
13	Letër shkrimi fotokopimi Kancelari	8	10	7	3	70%	88%
14	Bojë printeri e fotokopjues	7	20	12	8	60%	171%
15	Shpenzime sigurimi i jetës të punonjësve zjarrfikës	575	600	550	50	92%	96%
16	Shpenzime udhetime brenda dhe jashtë vëndit	40	80	46	34	58%	115%
17	Uniforma pune	682	1,113	894	219	80%	131%
18	Riparim paisje makinash	384	400	398	2	100%	104%
19	Vendime gjyqesore		1,055	1,055	-	100%	
	TOTAL MZSH	3,257	5,574	4,595	979	82%	141%

6.3 Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik Vendor – AC122

Në këtë program përfshihet administrimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore, mbrojtja e konsumatorëve, organizimi ose mbështetja e shërbimeve veterinarë për blegtorinë, kontrollin ushqimor, si dhe mbështetja dhe promovimi i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të Bashkisë, si dhe projektet në fushën e turizmit.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për periudhën janar-dhjetor 2024 ka qenë 64,286 mijë lekë ose realizuar në masën 48%, kundrejt planit vjetor të vitit 2024, në vlerën 132,603 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për paga dhe sigurime shoqërore shëndetësore për vitin 2024 ka qenë 13,746 mijë lekë dhe realizimi 13,295 mijë lekë ose 97%. Fondi i planifikuar për shpenzime korrente për vitin 2024 ka qenë 31,844 mijë lekë dhe realizimi 18,260 mijë lekë ose 57%. Fondi i planifikuar për shpenzime për investime ka qenë 87,013 mijë lekë dhe realizimi 32,731 mijë lekë, ose 38%.

Tabela e raportimit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore jepet si më poshtë:

000/lekë

Programi	Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik Vendor					Kodi i Programit		AC122	
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	% e realizimit
		Fakti i vitit paraardhës 2023	PBA Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Fakti i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Diferenca	
600	Paga	10,282	10,880	10,880	11,762	11,762	11,399	-363	97%
601	Sigurime Shoqërore	1,717	1,820	1,820	1,984	1,984	1,896	-88	96%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	13,682	43,632	43,632	31,844	31,844	18,260	-13,584	57%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	48							
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	25,729	56,332	56,332	45,590	45,590	31,555	-14,035	69%
230	Kapitale të Patrupëzuara								
231	Kapitale të Trupëzuara	25,104	19,653	19,653	87,013	87,013	32,731	-54,282	38%
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale	25,104	19,653	19,653	87,013	87,013	32,731	-54,282	38%
Totali (korrente + kapitale)		50,833	75,985	75,985	132,603	132,603	64,286	-68,317	48%

Ky program ka buxhetuar dhe realizuar shpenzimet dhe shërbimet sipas 9 produkteve të përcaktuara sipas metodologjisë së përgatitjes së buxhetit.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve sipas produkteve dhe llogarive ekonomike :

000/lekë

Produktet/Shpenzimet	V426AAA-Shërbimi i Stafit të menaxhimit të fondit Pyjor dhe Kullosor	V422AAA-Pagesa për stafin sektori i bujqesisë	V416AAC-Subjekte të sistemuara në Tregun e Gjësë së Gjallë	V416AAB-Subjekte të sistemuara në Tregun e Ushqimeve	V476AAB-Promovim i i Turizmit	V426AAB-Inspektim dhe kontroll i sipërfaqes pyjore/kullosore	V413AAC-Promovim i biznesit dhe zhvillimit	V426AAE-Sipërfaqe pyjore e rehabilituar	P413AAB-Qendra e Kreativitetit i faza II	Total
PI 600	9,958	1,804								11,762
Fakt 600	9,594	1,804								11,398
PI 601	1,682	302								1,984
Fakt 601	1,594	302								1,896
PI 602			431	1,675	26,533	3,206				31,845
Fakt 602			131	1,315	14,656	2,158				18,260
PI 231			100	274	337		7,000	69,055	10,247	87,013
Fakt 231				230	251			22,007	10,244	32,732
Total PI AC122	11,640	2,106	531	1,949	26,870	3,206	7,000	69,055	10,247	132,604
Total Fakt AC122	11,188	2,106	131	1,545	14,907	2,158	-	22,007	10,244	64,286
% e realizimit	96%	100%	25%	79%	55%	67%	0%	32%	100%	48%

Produktet me realizim të mirë janë: -Shërbimi i Stafit të menaxhimit të fondit Pyjor dhe Kullosor 96%, Pagesa për stafin sektori i bujqesisë 100%, Subjekte të sistemuara në Tregun e Gjësë së Gjallë 79% si dhe Qendra e Kreativitetit faza II 100%.

Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve korrente	Realizimi	PI 2024	Realizimi	Diferencë	% e realizimit	Real2024/real2023
		2023		2024			
1	Karburant makina	1,057	1,920	1,260	660	66%	119%
2	Siguracion makine	64	120	59	61	49%	92%
3	TVMP dhe SGS	12	35	-	35	0%	0%
4	Riparim automjeti	72	50	48	2	96%	67%
5	Larje automjeti	15	58	18	40	31%	120%
6	Shpenzime udhëtim dieta	11	200	72	128	36%	655%
7	Blerje uniforma		750	659	91	88%	
8	Energji elektrike stacioni i pyjeve Voskopojë dhe Vithkuq	7	17	7	10	41%	100%
9	Letër shkrimi fotokopimi Kancelari	7	16	11	5	69%	157%
10	Bojë printeri e fotokopjues	23	40	24	16	60%	104%
	TOTAL Administrimi I Pyjeve	1,268	3,206	2,158	1,048	67%	170%

6.4 Mbrojtja e Mjedisit – AD122

Ky program konsiston në mbledhjen, depozitim të mbeturinave, trajtimin, pastrimin e rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Mbrojtja e ajrit dhe e klimës, mbrojtja e tokave dhe ujrave nëntokësore, reduktimi i zhurmave dhe vibracioneve, mbrojtja ndaj rrezatimeve, si dhe veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për periudhën janar-dhjetor 2024 ka qenë 189,385 mijë lekë ose realizuar në masën 91% kundrejt planit vjetor të vitit 2024, në vlerën 207,733 mijë lekë dhe krahasuar me realizimin e vitit 2023 ka një rritje prej 36%.

Fondi i planifikuar për paga dhe sigurime shoqërore shëndetësore për vitin 2024 ka qenë 4,339 mijë lekë dhe realizimi 4,261 mijë lekë ose 98%. Fondi i planifikuar për shpenzime korrente për vitin 2024 ka qenë 193,394 mijë lekë dhe realizimi 185,123 mijë lekë ose 96%. Fondi i planifikuar për shpenzime për investime ka qenë 10,000 mijë lekë. Tabela e raportimit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore jepet si më poshtë:

Programi	Mbrojtja e Mjedisit					Kodi i Programit		AD122	
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit paraardhës 2023	PBA Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Fakti i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Diferenca	% e realizimit
600	Paga	3,161	3,400	3,400	3,718	3,718	3,651	-67	98%
601	Sigurime Shoqërore	526	570	570	621	621	610	-11	98%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	102,465	153,129	153,129	153,129	153,129	144,858	-8,271	95%
604	Transferta Korrente të Brendsh	32,546	36,990	36,990	40,265	40,265	40,265	0	100%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	50							
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	138,748	194,089	194,089	197,733	197,733	189,384	-8,349	96%
231	Kapitale të Trupëzuara		10,000	10,000	10,000	10,000		-10,000	0%
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale	0	10,000	10,000	10,000	10,000	0	-10,000	0
	Totali (korrente + kapitale)	138,748	204,089	204,089	207,733	207,733	189,384	-18,349	91%

Ky program ka buxhetuar dhe realizuar shpenzimet dhe shërbimet sipas 7 produkteve të përcaktuara sipas metodologjisë së përgatitjes së buxhetit. Planifikimi dhe realizimi sipas produkteve dhe llogarive ekonomike të programit AD122 Mbrojtja e Mjedisit, paraqiten sipas tabelave të mëposhtme:

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve sipas produkteve dhe llogarive ekonomike :

000/lekë

Produktet/Shpenzimet	V510AAA-Shërbimi i stafit të menaxhimit të mbetjes dhe pastrimit	V563AAB-Shërbimi i stafit të Inspektimit të mjedisit	V510AAD-Pastrimi i rrugëve dhe parqeve	V510AAB-Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane	P532AAA-Termoilozimi i banesave në bashkëpronësi	V510AAF-Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve	V563AAC-Promovimi i mbrojtjes së mjedisit	Total
PI 600	783	2,935						3,718
Fakt 600	782	2,870						3,652
PI 601	131	490						621
Fakt 601	131	479						610
PI 602			85,834	62,327		4,818	150	153,129
Fakt 602			79,114	61,122		4,622		144,858
PI 604						40,265		40,265
Fakt 604						40,264		40,264
PI 231					10,000			10,000
Fakt 231								-
Total PI AD122	914	3,425	85,834	62,327	10,000	45,083	150	207,733
Total Fakt AD122	913	3,349	79,114	61,122	-	44,886	-	189,384
% e realizimit	100%	98%	92%	98%	0%	100%	0%	91%

Produktet me realizim të mirë janë: - Shërbimi i stafit të menaxhimit të mbetjes dhe pastrimit 100%, Shërbimi i stafit të Inspektimit të mjedisit 98%, Depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve 100% si dhe Mbledhje dhe transportim i mbetjeve nga zonat urbane 98%.

6.5 Shërbimet Publike Vendore – AE122

Ky program, i cili menaxhohet nga Bashkia dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, përfshin funksionin e menaxhimit të rrjetit rrugor rural, menaxhimin e ujitjes dhe kullimit, transportin publik, ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të dëshmorëve, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit, mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësitë e njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për Bashkinë për periudhën janar-dhjetor 2024 ka qenë 67,485 mijë lekë, ose realizuar në masën 65% kundrejt planit 103,344 mijë lekë dhe krahasuar me realizimin e vitit 2023 ka një rritje prej 24%.

Fondi i planifikuar për paga dhe sigurime shoqërore shëndetësore për vitin 2024 ka qenë 1,562 mijë lekë dhe realizimi 1,556 mijë lekë ose 99%. Fondi i planifikuar për shpenzime korrente për vitin 2024 ka qenë 15,000 mijë lekë dhe realizimi 13,981 mijë lekë ose 93%. Fondi i planifikuar për shpenzime për investime ka qenë 86,782 mijë lekë dhe realizimi 51,948 mijë lekë, ose 60%.

Tabela e raportimit të shpenzimeve të këtij programi sipas artikujve buxhetore jepet si më poshtë:

000/lekë

Programi	Shërbimet Publike Vendore	Kodi i Programit							
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
Art.	Emertimi	Fakti i vitit paraardhës 2023	PBA Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Fakti i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Diferenca	% e realizimit
600	Paga	1,074	1,100	1,140	1,337	1,337	1,333	-4	100%
601	Sigurime Shoqërore	179	184	190	225	225	223	-2	99%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4,474	5,000	5,000	5,000	5,000	3,982	-1,018	80%
603	Subvencione	9,999	10,000	10,000	10,000	10,000	9,999	-1	100%
604	Transferata Korente të Brendshme							0	#DIV/0!
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ							0	#DIV/0!
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	15,726	16,284	16,330	16,562	16,562	15,537	-1,025	94%
230	Kapitale të Patrupëzuara							0	0%
231	Kapitale të Trupëzuara	38,592	64,000	99,992	86,782	86,782	51,948	-34,834	60%
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale	38,592	64,000	99,992	86,782	86,782	51,948	-34,834	60%
Totali (korrente + kapitale)		54,318	80,284	116,322	103,344	103,344	67,485	-35,859	65%

Ky program ka buxhetuar dhe realizuar shpenzimet dhe shërbimet sipas 5 produkteve të përcaktuara sipas metodologjisë së përgatitjes së buxhetit. Planifikimi dhe realizimi sipas produkteve dhe llogarive ekonomike të programit AE122 Shërbimet Publike Vendore, Bashkia paraqiten si më poshtë:

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve sipas produkteve dhe llogarive ekonomike :

000/lekë

Produktet/Shpenzimet	V457AAA-Shërbimi i Transportit Publik	V626AAB-Mirembajtja e sipërfaqes së varrezave	V457AAB-Qytetarë të subvencionuar në transportin publik	P452AAC-Investime në rrugë	P644AAC-Projekti i shfrytëzimit inteligjent i energjisë	Total
PI 600	663	675				1,338
Fakt 600	661	672				1,333
PI 601	112	114				226
Fakt 601	110	112				222
PI 602		5,000				5,000
Fakt 602		3,982				3,982
PI 603			10,000			10,000
Fakt 603			9,998			9,998
PI 231		485		86,195	103	86,783
Fakt 231		347		51,498	103	51,948
Total PI AE122	775	6,274	10,000	86,195	103	103,347
Total Fakt AE122	771	5,113	9,998	51,498	103	67,483
% e realizimit	99%	81%	100%	60%	100%	65%

Produktet me realizim të mire janë: - Shërbimi i Transportit Publik 99%, si dhe Qytetarë të subvencionuar në transportin public 100%,

6.6 Arsimi bazë dhe parashkollor – AG122

Në këtë program përfshihen shpenzimet operative për shkollën e Doktrinës së Krishterë/ Maltës, si shpenzime energji, ujë, telefon dhe karburant, si dhe investime te ndryshme në shkollat e arsimit bazë dhe parashkollor.

Fondi i planifikuar për shpenzime korrente për vitin 2024 ka qenë 900 mijë lekë dhe realizimi 853 mijë lekë ose 95%. Fondi i planifikuar për shpenzime për investime për rikonstruksione shkollash, ka qenë 80,759 mijë lekë dhe realizimi 18,332 mijë lekë, ose 23%.

000/lekë

Programi	Arsimi Bazë dhe Parashkollor	Kodi i Programit						AG122	
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
Art.	Emertimi	Fakti i vitit paraardhës 2023	PBA Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Fakti i Periudhës/ janar-dhjetor 2024	Diferenca	% e realizimit
600	Paga							0	#DIV/0!
601	Sigurime Shoqërore							0	#DIV/0!
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	862	900	900	900	900	853	-47	95%
603	Subvencione							0	#DIV/0!
604	Transferta Korente të Brendshme							0	#DIV/0!
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ							0	#DIV/0!
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	862	900	900	900	900	853	-47	95%
231	Kapitale të Trupëzuara	4,610	33,206	50,900	80,759	80,759	18,332	-62,427	23%
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale	4,610	33,206	50,900	80,759	80,759	18,332	-62,427	23%
Totali (korrente + kapitale)		5,472	34,106	51,800	81,659	81,659	19,185	-62,474	23%

Ky program ka buxhetuar dhe realizuar shpenzimet dhe shërbimet sipas 3 produkteve të përcaktuara sipas metodologjisë së përgatitjes së buxhetit. Planifikimi dhe realizimi sipas produkteve dhe llogarive ekonomike të programit AG122 Arsimi bazë dhe parashkollor, paraqiten si më poshtë:

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve sipas produkteve dhe llogarive ekonomike :

000/lekë

Produktet/Shpenzimet	V912AAJ-Shoqëria e Doktrinës së Krishterë Shkolla e Maltës	P912AAA-Rikonstruksion Shkollash Arsimi Bazë	P912AAB-Rikonstruksion biblioteka e fëmijëve	Total
PI 602	900			900
Fakt 602	853			853
PI 231			43,495	37,265
Fakt 231			18,241	91
Total PI AG122	900	43,495	37,265	81,660
Total Fakt AG122	853	18,241	91	19,185
% e realizimit	95%	42%	0%	23%

Tek produkti Shoqëria e Doktrinës së Krishterë Shkolla e Maltës, përfshihen të gjitha shpenzimet operative për këtë institucion dhe tek produkti Rikonstruksion Shkollash Arsimi Bazë është përfshirë financimi për investimet në shkolla me

